



Vlerësimi i peizazhit dhe burimeve natyrore dhe zhvillimi i kurrikulave për adresimin e nevojave të fermerëve për rritje kapacitetesh

Bashkia Librazhd

Përgatitur nga Instituti i Studimeve Ekonomike dhe Transferimit të Njohurive
(ISETNJ)

Për World Vision Shqipëri

© Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet në asnjë formë, përveçse me leje nga publikuesi.

Raporti u hartua nga:

Dr. Drini Imami

Dr. Edvin Zhllima

Prof. Engjell Skreli

Puna në terren u realizua me mbështetjen e stafit të zyrave lokale të World Vision Shqipëri në Librazhd.

Mbështetur nga:

World Vision Korea

Korrik 2020

Përmbajtja

1. Hyrje.....	7
2. Metodologjia.....	9
2.1. Mbledhja e të dhënave dytësore.....	9
2.2. Mbledhja e të dhënave parësore.....	9
2.2.1.Vrojtimi i strukturuar	9
2.2.2.Mbledhja e të dhënave nga përfaqësues të qeverisë qendrore	11
2.3. Përpunimi dhe analiza e të dhënave	12
2.3.1.Të dhënat sasiore.....	12
2.3.2 Të dhënat cilësore	13
3. Burimet, përdorimi i burimeve dhe potencialet e zhvillimit – të dhëna dytësore	14
3.1. Të dhëna të përgjithshme për bashkinë Librazhd	14
3.2. Vizioni dhe objektivat strategjike	16
3.3. Përdorimi i burimeve të bashkisë.....	16
4. Burimet, përdorimi i burimeve dhe potencialet e zhvillimit – të dhëna parësore.....	19
4.1. Burimet e bashkisë.....	19
4.1.1.Burimet njerëzore në bashkinë Librazhd	19
4.1.2.Burimet natyrore prodhuese në bashkinë Librazhd	21
5. Shfrytëzimi i burimeve të bashkisë.....	24
5.1. Prodhimi në fermë.....	24
5.2. Prodhimi i produkteve të përpunuara në fermë.....	26
5.3. Aktivitetet blegtorale të fermës.....	26
5.3.1.Prodhimi i produkteve blegtorale.....	29
5.4. Aksesi në treg.....	30
5.4.1.Prodhimi Bujqësor	30
5.4.2.Prodhimi Blegtoral.....	30
5.5. Të ardhura të krijuara dhe burimet e të ardhurave	31
6. Potencialet e zhvillimit në bashkinë Librazhd.....	34
7. Kapacitetet njerëzore dhe nevoja për rritjen e tyre	36
7.1. Vlerësimi i nevojave për rritje kapacitetesh dhe metoda e preferuar	36
7.1.1.Vlerësimi i nevojave prioritare për rritje kapacitetesh.....	36
7.1.2.Metoda e preferuar e rritjes së kapaciteteve.....	37
8. Ofruesi i këshillimit dhe informacionit, cilësia dhe qasja e shërbimit	38
8.1. Vlerësimi mbi ofruesin e këshillimit dhe informacionit, cilësinë dhe lehtësinë e qasjes.....	38
8.2. Situata dhe mënyra e komunikimit	40
9. Partnerët e zhvillimit për ofrimin e shërbimeve të këshillimit dhe informacionit.....	41
9.1. Partnerët e zhvillimit.....	41
9.2. Kapaciteti i partnerëve	42
10. Efektet e pandemisë Covid-19 mbi funksionimi e zinxhirëve të vlerës dhe sigurinë ushqimore	43
10.1. Efektet e pandemisë Covid-19 mbi funksionimi e zinxhirëve të vlerës.....	43
10.2. Efekti i pandemisë tek të ardhurat mujore familjare	47
10.3. Efektet e pandemisë Covid-19 mbi sigurinë ushqimore të familjeve	50
11. Konkluzione dhe rekomandime.....	55
12. Referencat.....	59
Anekset.....	60

Lista e tabelave

Tabela 1: Përmbledhja e pyetjeve kërkimore, metodave dhe outputeve/rezultateve	10
Tabela 2: Familjet e intervistuar dhe popullsia koresponduese	11
Tabela 3: Prevalenca e Pasigurisë (qasjes) Ushqimore në Familje (HFIAP).....	13
Tabela 4: Të dhëna të përgjithshme për bashkinë e Librazhdit dhe Prrrenjasit	14
Tabela 5: Tregues demografikë të zonës së studimit sipas njësive administrative	14
Tabela 6: Tregues të kapaciteteve prodhuese të zonës së studimit sipas njësive administrative	16
Tabela 7: Analiza SWOT - Sistemi bujqësor.....	17
Tabela 8: Familjet e intervistuar, popullsia koresponduese dhe përmasa e familjes.....	19
Tabela 9: Mosha mesatare sipas njësive administrative, bashkisë Librazhd dhe zonës së projektit.....	19
Tabela 10: Struktura moshore e popullsisë së intervistuar në Librazhd, zonën e projektit dhe në vend ...	19
Tabela 11: Raporti i varësisë në bashkinë Librazhd, zonën e projektit dhe vendin	20
Tabela 12: Struktura gjinore e popullsisë së intervistuar	20
Tabela 13: Të dhëna mbi tokën në pronësi	21
Tabela 14: Të dhëna mbi tokën e përdorur	22
Tabela 15: Të dhëna mbi tregun e qerasë në Librazhd dhe zonën e projektit.....	22
Tabela 16: Mesatare e sipërfaqeve të tokës kultivuar me produktet specifike të zonës dhe pjesa e fermerëve që prodhojnë këto produkte sipas njësive administrative dhe në total - Librazhd	24
Tabela 17: Prodhimi (kv/fermë) i produkteve bujqësore sipas njësive dhe në total - Librazhd.....	25
Tabela 18: Rendimenti mesatar për bimët e arave sipas popullatës në studim dhe totali në bashki	25
Tabela 19: Prodhimi i produkteve të përpunuara në fermë, pjesa e fermerëve që prodhon dhe pjesa e shitur e prodhimeve sipas njësive administrative dhe në total	26
Tabela 20: Fermat që merren me aktivitete begtorale dhe nr i kërësve për fermë sipas njësive administrative dhe në total për Bashkinë Librazhd.....	26
Tabela 21: Prodhimet blegtorale të fermës dhe pjesa e shitur e tyre sipas njësive dhe bashkisë Librazhd në total	29
Tabela 22: Shitja si përqindje ndaj prodhimit për produktet specifike të zonës dhe pjesa e fermerëve që i tregtojnë këto produkte sipas njësive administrative dhe në total për bashkinë Librazhd.....	30
Tabela 23: Prodhimet blegtorale të fermës dhe pjesa e shitur e tyre sipas njësive dhe bashkisë Librazhd në total	30
Tabela 24: Të ardhurat e familjeve në përqindje sipas burimit në Librazhd dhe sipas njësive administrative	31
Tabela 25: Shpenzimet, të ardhurat dhe kursimet familjare mujore në secilën njësi dhe në total në Librazhd	32
Tabela 26: Aktiviteti kryesor për antarët e familjes në moshë pune	32
Tabela 27: Emigrimi në Librazhd dhe zonën e projektit.....	33
Tabela 28: Perceptimet e fermerëve mbi produktin më të rëndësishëm potencial.....	34
Tabela 29: Metoda e preferuar e rritjes së kapaciteteve.....	37
Tabela 30: Ofruesi i këshillimit dhe informacionit	38
Tabela 31: Cilësia e këshillimit.....	39
Tabela 32: Qasja në këshillim dhe informacion.....	39
Tabela 33: Mjedisi ku komunikohet për teknologjinë e prodhimit.....	40
Tabela 34: Ndikimi i pandemisë në intensitetin e komunikimit	40
Tabela 35: Interneti si mënyrë komunikimi për informacion mbi teknologjinë e tregjet.....	41
Tabela 36: Partnerët e zhvillimit në Librazhd dhe zonën e projektit	42
Tabela 37: Perceptimi mbi kapacitetet e partnerëve për ofrimin e këshillimit dhe informacionit	42
Tabela 38: Ndryshimi i të ardhurave sipas kategorive për shkak të pandemisë për familjet në Librazhd (dhe sipas njësive administrative)	47
Tabela 39: Përgjigjet e pyetjes “Sa përqind të këtyre produkteve arrini ti prodhoni në fermën tuaj”	52
Tabela 40: Niveli i Pasigurisë (qasjes) Ushqimore në Familje - Librazhd	54
Tabela 41: Struktura moshore e popullsisë në Librazhd	60
Tabela 42: Perceptimet e fermerëve mbi aktivitetin e dytë dhe të tretë potencial	60
Tabela 43: Përqindjet e vlefshme (pjesa e të anketurave që i është përgjigjur pyetjes mbi ecurinë në vlerën e shitjeve të produkteve blegtorale krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2019 (bashkia Librazhd)	61

Tabela 44: Sipërfaqja e bimëve të arave sipas bashkive 2019	61
Tabela 45: Prodhimi i bimëve të arave sipas bashkive 2019	62
Tabela 46: Prodhimi i perimeve sipas bashkive 2019.....	62
Tabela 47: Gjendja numerike e drufrutorëve, 2019	62
Tabela 48: Prodhimi i drufrutorëve, 2019 në Ton.....	62
Tabela 49: Numri i krerëve të blegtorisë sipas bashkive, 2019	62
Tabela 50: Prodhimi i qumështit, 2019 (Ton).....	62
Tabela 51. Prodhimi i mishit - peshë e gjallë, 2019 (ton).....	63

Lista e figurave

Figura 1: Struktura arsimore e popullsisë së intervistuar.....	21
Figura 2: Perceptimet e fermerëve mbi burimet natyrore në bashkinë Librazhd.....	23
Figura 3: Ecuria e numrit të krerëve për fermat gjatë 5 viteve të fundit – Librazhd.....	27
Figura 4: Ecuria e numrit të krerëve për fermat gjatë 5 viteve të fundit – Njësia administrative Hotolisht	28
Figura 5: Ecuria e numrit të krerëve për fermat gjatë 5 viteve të fundit – Njësia administrative Qendër .	28
Figura 6: Ecuria e numrit të krerëve për fermat gjatë 5 viteve të fundit – Njësia administrative Qukës...	29
Figura 7: Nevoja prioritare për rritjen e kapaciteteve për produktin prioritar	36
Figura 8: Ecuria në vlerën e shitjeve të produkteve bujqësore krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2019 – Total Librazhd.....	43
Figura 9: Ecuria në vlerën e shitjeve të produkteve bujqësore krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2019 - Hotolisht	44
Figura 10: Ecuria në vlerën e shitjeve të produkteve bujqësore krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2019 – Qendër.....	44
Figura 11: Ecuria në vlerën e shitjeve të produkteve bujqësore krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2019 - Qukës	45
Figura 12: Ecuria në vlerën e shitjeve të produkteve blegtorale krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2019 - Librazhd.....	45
Figura 13: Ecuria në vlerën e shitjeve të produkteve blegtorale krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2019 - Hotolisht	46
Figura 14: Ecuria në vlerën e shitjeve të produkteve blegtorale krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2019 - Qendër	46
Figura 15: Ecuria në vlerën e shitjeve të produkteve blegtorale krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2019 - Qukës	47
Figura 16: Përgjigjet e pyetjes “A kanë pësuar këto të ardhura ulje për shkak të pandemisë?” - Librazhd	48
Figura 17: Përgjigjet e pyetjes “A kanë pësuar këto të ardhura ulje për shkak të pandemisë?” – Hotolisht	48
Figura 18: Përgjigjet e pyetjes “A kanë pësuar këto të ardhura ulje për shkak të pandemisë?” – Qendër	49
Figura 19: Përgjigjet e pyetjes “A kanë pësuar këto të ardhura ulje për shkak të pandemisë?” - Qukës...	49
Figura 20: Shkalla e vështirësisë për konsumin e ushqimeve të mëposhtme përgjatë muajit mars-prill – Librazhd.....	50
Figura 21: Shkalla e vështirësisë për konsumin e ushqimeve të mëposhtme përgjatë muajit mars-prill – Hotolisht.....	50
Figura 22: Shkalla e vështirësisë për konsumin e ushqimeve të mëposhtme përgjatë muajit mars-prill – Qendër.....	51
Figura 23: Shkalla e vështirësisë për konsumin e ushqimeve të mëposhtme përgjatë muajit mars-prill – Qukës	51
Figura 24: Rezultatet e pyetjes “Sa i/e shqetësuar jeni nëse do të jeni në gjendje apo jo të siguroni për veten dhe familjen tuaj ushqim dhe artikujt bazë gjatë 2 muajve të ardhshëm?”	52
Figura 25: Përgjigjet e pyetjeve për të vlerësuar pasigurinë e familjes për të aksesuar produkte ushqimore - Librazhd.....	53
Figura 26: Shqetësimet ndaj sigurimit të ushqimit të nevojshëm për familjen ndodhi prej pandemisë - Librazhd.....	53

Figura 27: Niveli i sigurisë ushqimore për familjet në bashkinë Librazhd dhe sipas njësive administrative respektive	54
Figura 28: Nevoja e parë prioritare për rritje kapacitetesh për produktin e dytë prioritar	61

1. Hyrje

Varfëria ka qenë dhe vazhdon të jetë një shqetësim madhor i World Vision Shqipëri & Kosovë (WVAK). Qëllimi i strategjik i organizatës është që të kontribuojë në mirëqenien e fëmijëve. Në Shqipëri, WVAK punon me fëmijë, familjet e tyre dhe komunitetet në nëntë Zona Programi (ZP), që ndodhen në Durrës, Lezhë, Kurbin, Librazhd, Shkodër, Dibër, Korçë, Tiranë dhe Elbasan. Qasja kryesore e WVAK është fuqizimi i komuniteteve në mënyrë që atyre t'u mundësohet pjesëmarrja në procese zhvillimore. Puna e WVAK konsiston në aftësimin e fermerëve që të shprehin vetë nevojat e tyre për të qenë sa më efikas, të ekspozohen ndaj mësimave sipas parimit të Empowered World View (EWV), të zhvillojnë njohuri bazë për tregjet dhe menaxhimin financiar, si edhe për shërbimet apo produktet që ofrohen nga institucionet mikrofinanciare, që të jenë në gjendje që të përdorin punën dhe mjetet e tyre për zhvillimin e bujqësisë dhe menaxhimin e burimeve natyrore në mënyrë të qëndrueshme.

Programi i Zhvillimit Ekonomik të WVAK synon të arrijë fuqizim të qëndrueshëm ekonomik të familjeve dhe komuniteteve në ZP si Dibra, Korça, Kurbin dhe Librazhd, duke ngritur kapacitetet e tyre për t'u përballur me sfidat dhe për të përmirësuar mirëqenien e fëmijëve. Duke marrë parasysh këtë qëllim, kohët e fundit Programi i Zhvillimit Ekonomik të WVAK kërkoi një vlerësim për identifikimin e gamës së ndërhyrjeve specifike të kërkuara për zbatimin e programeve të zhvillimit të kapaciteteve të integruara në fshatrat e përfshira nga Programi i Zhvillimit Ekonomik bazuar në një analizë të burimeve dhe nevojave të komuniteteve të fermerëve në fshatra të veçantë në zonat e programit në Dibër, Korçë, Kurbin dhe Librazhd.

Raporti i vlerësimit synon që të ofrojë rekomandime për zhvillimin e kapaciteteve kryesore që mundësojnë familjet e varfra rurale të synuara apo të mbështetura nga WVAK të shfrytëzojnë potencialet dhe burimet lokale të disponueshme. Qëllimi qëndron në mobilizimin e komuniteteve për të punuar së bashku për të marrë kontrollin e zhvillimit dhe për të ruajtur mjedisin e tyre, duke u siguruar kështu komuniteteve rurale një potencial më të madh për të hartuar dhe menaxhuar nismat e tyre të zhvillimit. Kështu që, pjesë e këtij studimi është identifikimi i programeve trajnuese për rritjen e kapaciteteve të popullsisë së varfër në zonat rurale të përzgjedhura si edhe informacione përkatëse në lidhje me ofruesit e shërbimeve dhe format më të përshtatshme për ofrimin e shërbimeve dhe këshillimit.

Qëllimi i këtij studimi është vlerësimi i potencialit me fokus:

- Identifikimi i burimeve natyrore dhe të bujqësisë (duke përfshirë prodhimin bujqësor, ujin, tokën, pyllin / pemët dhe tokat / kullotat) që mund të menaxhohen dhe zhvillohen për të kontribuar në fuqizimin ekonomik të familjeve në ZP Dibër, Maliq, Kurbin dhe Librazhd.
- Identifikimi i partnerëve të mundshëm që kanë një rol në përmirësimin e mundësive të familjeve për aktivitete që sjellin të ardhura, në secilën ZP.
- Vlerësimi i nevojave për ndërtimin e kapaciteteve të familjeve të varfëra për menaxhimin e bujqësisë dhe burimeve natyrore në zonat rurale.
- Ofrimi i ekspertizës dhe ndërtimi i kurrikulave në përputhje me nevojat e fermerëve për të mundësuar përdorimin e potencialeve lokale në secilën nga fushat e programit dhe për të përmirësuar përfshirjen e familjeve në aktivitete nga të cilat mund të gjenerohen të ardhura.

Instituti i Studimeve Ekonomike dhe Transferimit të Njohurive (ISETNJ) është përzgjedhur nga WVAK për të kryer këtë studim, për shkak të përvojës dhe ekspertizës unike që ka kjo organizatë. Ky raport, është pjesë e një serie raportesh që kanë strukturë të njëjtë (një për secilën ZP: Dibër, Kurbin, Librazhd dhe Maliq). Raporti është i strukturuar në 7 kapituj, ku hyrja dhe metodologjia përsëriten në çdo raport. Kapitulli 3 paraqet bazuar në të dhënat dytësore disa tipare të kushteve zhvillimore të zonës. Kapitulli 4 rendit burimet kryesore sipas opinionëve të të anketuarve dhe drejtuesve të komunitetit përkatës. Kapitulli 5 vijon me përshkrimin e mënyrave të shfrytëzimit të këtyre burimeve duke treguar prodhimin bimor dhe shtazor në zonë dhe përshkruar rentat e derivuara nga këto aktivitete. Kapitulli 6 tregon potencialet e zhvillimi të zonës bazuar në qëndrimet e fermerëve. Kapitulli 7 tregon nevojat për kapacitete njerëzore dhe preferencat e përfituesve të mbështetjes së WVAK për rritjen e këtyre kapaciteteve. Kapitulli i mëtejshëm tregon vlerësimin e të intervistuarve për cilësinë e shërbimeve të ofruar nga aktorë të ndryshëm. Kapitulli 9 tregon aktorët kryesorë të preferuar nga të anketuarit për të ofruar shërbime për ngritje kapacitetesh. Kapitulli 10

tregon efektet kryesore të pandemisë dhe kapitulli 11 përmyll raportin me konkluzionet dhe rekomandime.

Studimi bazohet kryesisht në një vrojtim me zgjedhje të kryer ndaj përfituesve të mbështetjes së WVAK. Në kohën e kryerjes së vrojtimit pandemia ishte në fazën kulmore. Për shkak të rrezikshmërisë që paraqiste kontakti i drejtpërdrejtë WVAK zbatoi anketimin nëpërmjet komunikimit në distancë (telefon dhe hedhja e të dhënave në kompjuter). Kjo qasje sjell kufuzime në të kuptuarin e pyetjeve, në plotësimin e përgjigjeve dhe në saktësinë e përgjigjeve. Pyetje opsionale në lidhje me efektin e pandemisë patën një numër të ulët përgjigjesh. Ky kufizim u adresua nga ekspertët pas vrojtimit duke rritur numrin e intervistave për të saktësuar të dhënat.

2. Metodologjia

2.1. Mbledhja e të dhënave dytësore

Burime të ndryshme janë përdorur për të mbledhur të dhëna dytësore, përfshirë Drejtoritë Rajonale të Bujqësisë, qeverisjen lokale (planet lokale të zhvillimit ose strategjitë e zhvillimit rajonal të bashkive), Instituti i Statistikave në Shqipëri (INSTAT), studimet e kryera nga agjenci të ndryshme zhvillimi etj. Gjatë periudhës së studimit, ekipi i ISETNJ ka bashkëpunuar ngushtë me ekipin e WVAK në lidhje me identifikimin e burimeve të rëndësishme të të dhënave sekondare – autorët e studimit gjejnë rastin të vlerësojnë mbështetjen e pakufizuar nga WVAK.

2.2. Mbledhja e të dhënave parësore

Katër instrumente kryesore janë përdorur për përfitim të të dhënave parësore, përkatësisht vrojtimi i strukturuar i fermerëve, intervistat gjysmë të strukturuar të thelluara dhe takimet e validimit.

2.2.1. Vrojtimi i strukturuar

Vrojtimi i strukturuar targetoi ferma familjare si njësi të analizës në secilën ZP (pra përkatësisht në Dibër, Librazhd, Kurbin dhe Maliq) – pyetësi mundësonte mbledhjen e të dhënave socio-ekonomike (si mosha, arsimit, statusi i punësimit - në fermë dhe punësimi jashtë fermës, përfshirë emigrimin); të dhëna rreth aktiviteteve bujqësore dhe jo-bujqësore; burimeve të të ardhurave etj. Gjithashtu u mbledhën të dhëna rreth të ardhurave për potencialet e aktivitetit ekonomik bazuar në burimet natyrore; hapësirat për zhvillim; nevojat për ndërtimin e kapaciteteve që lidhen me aktivitetet kryesore bujqësore, duke përfshirë nevojat për teknologjinë, menaxhimin financiar, veprimin kolektiv (bashkëpunimi me njëri-tjetrin), marrëdhëniet me blerësin dhe aksesin në treg, si edhe menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore.

Tabela 1: Përmbledhja e pyetjeve kërkimore, metodave dhe outputeve/rezultateve

Cështjet/temat	Metoda	Burimi	Outputi/Rezultati
Vlerësimi i burimeve natyrore (tokë bujqësore, kullota pyjore, ujë) në secilën ZP	Rishikim literature	Strategjitë e zhvillimit rajonal, planet lokale të zhvillimit, agjencitë rajonale të bujqësisë	Përshkrimi cilësor i burimeve natyrore për secilën zonë të programit duke përdorur tregues krahasues të disponueshëm
	Intervista gjysëm të strukturuar të thelluara *		
	Workshopet apo takimet validuese***		
Vlerësimi i potencialeve për aktivitetet ekonomike të fermave (bimët, bagëtitë, përpunimin në fermë, turizmin, etj.) (përfshirë produktet tipike) bazuar në burimet natyrore	Rishikim literature	Literatura	Një listë e aktiviteteve të mundshme që lidhen me burimet natyrore (kulturat bujqësore, blegtoria, përpunimi në fermë, turizmin, etj.) vlerësimi cilësor (me të dhëna cilësore) i potencialeve dhe renditja e mundshme
	Intervista gjysëm të strukturuar të thelluara (aktorë të mirëinformuar) *		
	Vrojtimi i strukturuar me fermerë**		
	Të dhëna të mbledhura nga zyrtarë të qeverisë vendore		
	Workshopet apo takimet validuese***		
Gjendja aktuale e shfrytëzimit të mundësive dhe burimeve si edhe hapësira për zhvillim	Rishikim literature	Të dhëna administrative (ARZH)	Vlerësimi i gjendjes aktuale dhe potencialeve përfshi hapësirën për zhvillim bazuar në kushtet e ofertës dhe kërkesës
	Intervista gjysëm të strukturuar të thelluara *		
	Vrojtimi i strukturuar me fermerë**		
	Të dhëna të mbledhura nga zyrtarë të qeverisë vendore		
	Workshopet apo takimet validuese***		
Vlerësimi i nevojave për ndërtimin e kapaciteteve në lidhje me aktivitetet e mundshme (kulturat bujqësore, blegtoria, përpunimi në fermë, turizmin, etj.)	Intervista gjysëm të strukturuar të thelluara (aktorë të mirëinformuar)*		Nevojat për ndërtimin e kapaciteteve në drejtim të teknologjisë, menaxhimit financiar, veprimet kolektiv, marrëdhëniet me blerësit, menaxhimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore, etj.
	Vrojtim i strukturuar**		
	Të dhëna të mbledhura nga zyrtarë të qeverisë vendore		
	Workshopet apo takimet validuese***		
Identifikimi i partnerëve, dhe vlerësimi i interesave dhe kapaciteteve të tyre	Intervista gjysëm të strukturuar të thelluara (aktorë të mirëinformuar) *		Lista e partnerëve dhe interesi dhe kapacitetet relevante - Rekomandime për partnerët që kanë më shumë potencial
	Workshopet apo takimet validuese***		
Vlerësimi i ekspertizës që ofrohet në ZP	Intervista gjysëm të strukturuar të thelluara (aktorë të mirëinformuar) *		OJF, qeveria (struktura të qeverisë qendrore dhe lokale), konsulentët
	Workshopet apo takimet validuese***		

Burimi: Punim i autorëve

Hartimi dhe testimi i pyetësorit

Disa aspekte metodologjike u morën parasysh gjatë hartimit të pyetësorit, përfshirë madhësia e pyetësorit; formulimi i pyetjeve (pyetjet u formuluan të tilla që të ishin lehtësisht të kuptueshme nga të anketuarit); renditja e pyetjeve (pyetjet e ndjeshme dhe të vështira për t'u përgjigjur u vendosen në fund). Pyetësori u testua dhe u përmirësua përpara fillimit të mbledhjes së të dhënave. I gjithë ky proces u krye në bashkërendim të ngushtë me stafin e WVAK.

Përcaktimi i mostrës

Mostra, përfshirë këtu fshatrat si edhe familjet që u përfshinë në vrojtimit u zgjodh nga stafi i WVAK, në përputhje me zonat ku operojnë dhe familjet që mbështesin. Në këtë raport (Librazhd) janë përgjigjur gjithsej 111 përfaqësues familjesh fermere, përkatësisht 27 në njësinë administrative Hotolisht, 70 në njësinë administrative Qendër dhe 14 në njësinë administrative Qukës të Bashkisë Përrenjas. Përderisa, përfaqësuesi i familjes u përgjigj për anëtarët e familjes, atëherë numri i individëve të përfshirë në analizë është pesë herë më i lartë (Tabela 2).

Tabela 2: Familjet e intervistuar dhe popullsia koresponduese

Treguesit	Njësia administrative			Total Librazhd	Zona e projektit
	Hotolisht	Qendër	Qukës		
Numri i familjeve të intervistuar	27	70	14	111	439
Numri i popullsisë që i korrespondon familjeve të intervistuar ¹	131	344	72	547	2,115

Burimi: Autorët bazuar në të dhënat e vrojtimit të strukturuar

Zbatimi i vrojtimit

Ekipi i ISETNJ ndoqi një seri fazash për të mundur një zbatim të suksesshëm të këtij studimi, si dhe për të grumbulluar informacionin e saktë nga grupet e synuara. Për nevojat specifike të këtij vlerësimi, ekipi i ISETNJ ndoqi një qasje që përfshin dy faza të anketimit. Faza përgatitore konsistoi në këto hapa:

- hartimi dhe përfundimi i pyetësorit;
- përcaktimi i mostrës;
- në bashkëpunim të ngushtë me ISETNJ, WVAK programoi platformën e hedhjes së të dhënave (kjo u krye nga stafi i WVAK);
- pas programimit për përdorimin e tabletave/PC-ve, ISETNJ bëri seanca pilot të shkurtra, për të identifikuar probleme dhe kështu u krye përmirësimi i pyetësorit;
- më pas ISETNJ zhvilloi seanca trajnimit për stafin e WVAK për të kryer intervistat. Sesionet e trajnimit ofruan shpjegime për kontekstin dhe përmbajtjen e pyetjeve të pyetësorit;
- vrojtimi u implementua nga stafi i WVAK.

2.2.2. Mbledhja e të dhënave nga përfaqësues të qeverisë qendrore

Informacioni që u mblodh përmes këtij instrumenti përfshin: potencialet e veprimtarisë ekonomike të fermave (të korrave, bagëtime, aktivitetet e përpunimit në fermë, turizmit, etj.) (përfshirë produktet dhe shërbimet tipike) bazuar në burimet natyrore; gjendja aktuale e shfrytëzimit të mundshëm dhe hapësira për zhvillim; nevojat për ndërtimin e kapaciteteve në lidhje me aktivitetet e mundshme bujqësore, etj.

Për të përfutur më shumë informacion, sidomos të natyrës cilësore, që nuk mund të përftohej dot nga pyetësori/vrojtimi i strukturuar si edhe për të validuar dhe kuptuar më mirë gjetjet nga vrojtimi i strukturuar u realizuan intervista gjysëm të strukturuar në grup si edhe me individë. Për këtë qëllim në pyetësorët gjysëm të strukturuar u përfshi informacion për aspekte të ndryshme si psh. strategjitë e ardhshme të fermës dhe jetesës (sjellja e planifikuar), vlerësimi i burimeve natyrore (tokë bujqësore,

¹ Diferenca mes numrit të popullsisë që i korrespondon familjeve të intervistuar dhe numrit të raportuar në tabela ose figura, përfaqëson të dhëna të munguara (missing cases).

kullota pyjore, ujë) financimi në secilën ZP; potencialet e aktivitetit ekonomik të familjes së fermave (kulturë bujqësore, bagëti, përpunim në fermë, turizëm, etj.) (përfshirë produktet tipike) bazuar në burimet natyrore; identifikimi i partnerëve, interesave dhe kapaciteteve të tyre; ekspertizën e disponueshme; nevojat për ndërtimin e kapaciteteve që lidhen me aktivitetet e ndryshme bujqësore dhe blegtorale, duke marrë parasysh nevoja të ndryshme siç janë nevojat për sa i përket teknologjisë, menaxhimit financiar, veprimet kolektiv, marrëdhëniet me blerësit, menaxhimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore, etj.

Intervistat gjysmë të strukturuar u kryen nga ekipi i ISETNJ, bazuar në pyetësorët e përgatitur paraprakisht. Pyetësorët gjysëm të strukturuar u përdorën si "udhëzues" dhe jo si "recetë", duke mundësuar lirshmërinë në komunikim dhe duke mundësuar hapësira për të diskutuar aspekte relevante që dilnin gjatë intervistave. Gjatë kryerjes së intervistave, anëtarët e ekipit të ISETNJ mbajtën shënime dhe bënë përmbledhjen e gjetjeve të cilat u reflektuan në raport.

2.3. Përpunimi dhe analiza e të dhënave

2.3.1. Të dhënat sasiore

Ekipi i ISETNJ i analizoi të dhënat përmes programit SPSS, një program i specializuar për analizën statistikore për përpunimin e rezultateve dhe analizave statistikore. Në bazën e të dhënave të SPSS u specifikuan emërtesat dhe tipologjia e variablave.

Gjatë përpunimit dhe raportimit të të dhënave u përgatitën tabela të shumta që reflektonin të gjitha rezultatet kryesore (në formë frekuencash dhe tabelash të kryqëzuara). Pas analizës paraprake të rezultateve, u vazhdua me interpretimin dhe vizualizimin e të dhënave (në formë tabelash dhe grafikësh).

Dy tregues u përlllogaritën duke përdorur të dhënat e studimit që janë Niveli i Pasigurisë (qasjes) Ushqimore ne Familje (Household Food Insecurity Access-related Domains ose HFIAS²) dhe Prevalenca e Pasigurisë (qasjes) Ushqimore ne Familje (HFIAP).

Niveli i Pasigurisë (qasjes) Ushqimore në Familje ofron informacion të përmbledhur mbi mundësinë që një familje të përjetojë një ose më shumë sjellje në secilën nga tre fushat e pasqyruara në HFIAS të cilat janë ankthi dhe pasiguria, cilësi e pamjaftueshme dhe sasi e pamjaftueshme ushqimore. Treguesi i HFIAS është një vlerë e vazhdueshme e shkallës së mos-sigurimit ushqimor (qasjes) në familje me vlera të cilat variojnë nga 0 në 15, ku sa më i lartë të jetë rezultati, aq më shumë pasiguri ushqimore (qasje) e ka përjetuar një familje.

Një tregues tjetër është Prevalenca e Pasigurisë (qasjes) Ushqimore në Familje (HFIAP): Treguesi HFIAP i kategorizon familjet në katër nivele të pasigurisë (apo qasjes) ushqimore shtëpiake (Tabela 3):

1. Familje me akses të sigurtë në ushqim,
2. Familje me nivel të moderuar të pasigurisë ushqimore. Një nivel i moderuar i pasigurisë ushqimore të familjes do të thotë se familja shqetësohet për mos pasje ushqimi të mjaftueshëm ndonjëherë ose shpesh, dhe / ose nuk është në gjendje të hajë ushqime të preferuara, dhe / ose ha një dietë më monotone sesa ajo e dëshiruar dhe / ose disa ushqime të konsideruara të padëshirueshme, por vetëm rrallë. Por kjo nuk tkurr sasinë dhe as nuk përjeton asnjë nga tre kushtet më të rënda (mbarimi i ushqimit, shkuarja në shtrat i uritur, ose shkuarja e tërë ditës dhe natës pa ngrënë).
3. Familje me nivel të konsiderueshëm të pasigurisë ushqimore. Një familje me nivel të konsiderueshëm të pasigurisë së ushqimit sakrifikon cilësinë më shpesh, duke ngrënë një dietë monotone ose ushqime të padëshirueshme ndonjëherë ose shpesh, dhe /ose ka filluar të shkurtojë sasinë duke zvogëluar

² Për më tepër konsultohuni tek lidhja http://www.fao.org/fileadmin/user_upload/eufao-fsi4dm/doc-training/hfiap.pdf

madhësinë e vakteve ose numrin e vakteve, rrallë ose ndonjëherë. Por nuk pëson asnjë nga tre kushtet më të rënda. Një familje me pasiguri të lartë ushqimore është e prirur për të ulur shpesh sasinë e vaktit ose numrin e vakteve, dhe/ose përjeton ndonjë nga tre kushtet më të rënda (mbarimi i ushqimit, shkimi në shtrat i uritur, ose shkuarja e tërë ditës dhe natës pa ngrënë), edhe aq rrallë si rrallë.

4. Familje me nivel të lartë të pasigurisë ushqimore janë familje të cilat vuajnë shpesh ndodhinë e ngjarjeve si mbarimi i ushqimit, të shkuarit në shtrat i uritur, ose shkuarja e tërë ditës dhe natës pa ngrënë.

Tabela 3: Prevalenca e Pasigurisë (qasjes) Ushqimore në Familje (HFIAP)³

Pyetje	1-Rrallë (një apo dy herë)	2-Ndonjëherë (3 deri në 10 herë)	3-Shpesh (mëshumë se 10 herë)
U shqetësove se familja juaj nuk do të kishte ushqim të mjaftueshëm?			
Ju duhet të ushqeheshit me një larmi të kufizuar të ushqimeve?			
Ju është dashur të konsumoni disa ushqime që ju me të vërtetë nuk doni të hani?			
Ju ose ndonjë anëtar i familjes duhet të hani një vakt më të vogël se sa nevojitej?			
Ju ose ndonjë anëtar i familjes duhet të hani më pak vakte në dite?			

- 1. Familje me siguri ushqimore
- 2. Familje me nivel të moderuar të pasigurisë ushqimore
- 3. Familje me nivel të konsiderueshëm të pasigurisë ushqimore
- 4. Familje me nivel të lartë të pasigurisë ushqimore

2.3.2 Të dhënat cilësore

Shënimet e kryera gjatë intervistave gjysëm të strukturuar apo takimeve në grupe u analizuan duke përdorur teknikat e analizës cilësore, me qëllimin për të përmbledhur çështjet më të rëndësishme dhe më interesante të përmendura në intervista.

³ Coates, J., Swindale, A., & Bilinsky, P. (2007). Household Food Insecurity Access Scale (HFIAS) for measurement of food access: indicator guide: version 3. E aksesueshme online në lidhjen: http://www.fao.org/fileadmin/user_upload/eufao-fsi4dm/doc-training/hfias.pdf

3. Burimet, përdorimi i burimeve dhe potencialet e zhvillimit – të dhëna dytësore

3.1. Të dhëna të përgjithshme për bashkinë Librazhd

Librazhdi shtrihet në një territor i cili kufizohet në veri me bashkinë Bulqizë, në lindje me Republikën e Maqedonisë së Veriut, në jug me bashkinë Përrenjas dhe në perëndim me bashkitë Elbasan dhe Tiranë. Kryeqendra e Bashkisë është qyteti i Librazhdit. Njesia Administrative Qukës është pjesë e Bashkisë Përrenjas e cila kufizohet me Librazhdin, Bulqizën, Pogradecin dhe Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Bashkia përbëhet nga 7 njësi administrative e cila ka nën administrimin e saj një qytet dhe 52 fshatra. Bashkia e re e Librazhdit shtrihet në lindje të Shqipërisë, në një zonë me bimësi të pasur, hapësira të gjera pyjore dhe burime të shumta hidrike. Njesia administrative Qukës përbëhet nga 11 fshatra.

Sipas Censurit të vitit 2011, Librazhdi ka një popullsi prej 31,892 banorësh dhe Njësia Administrative Qukës prej 8,211 banorësh. Ndërkohë që sipas Regjistrimit Civil, kjo bashki numëron 44,181 banorë. Bashkia e re shtrihet në një sipërfaqe prej 793.36 km². Sipas regjistrimit civil, densiteti i popullsisë është 55.68 banorë/km² sipas ndërsa sipas censurit, densiteti është 40 banorë/km². Pjesa më e madhe e popullsisë e Bashkisë Librazhd dhe njësisë administrative Qukës jeton në zonat rurale.

Tabela 4: Të dhëna të përgjithshme për bashkinë e Librazhdit dhe Përrenjasit

Treguesi		Librazhdi	Përrenjasi
Tregues gjeografikë	Sipërfaqja e njësisë vendore	140,487 ha	32,382 ha/
	Numri i popullsisë	44,820 banorë	33,235 / Qukës 8,211
Sipërfaqe natyrore	Sipërfaqja e përgjithshme e territorit bujqësor	9,975 ha	8,660 ha
	Sipërfaqe Primare (Boniteti I-IV) (ha)	798 ha	890 ha
	Sipërfaqe e përgjithshme	69,200 Ha	26,458 ha
	Sipërfaqe pyjore	31,372.8 ha	12,654.6 ha
	Sipërfaqe me kullota	31.3 ha	
	Gjatësia e lumenjve dhe prrenjëve kryesor	25 km	25 km
	Zona të rëndësishme kombëtare dhe zona të mbrojtura natyrore dhe kulturore	138,882 ha	13,200 ha + zona bufer 14,100 ha
Zonat infrastrukturore	Gjatësia e rrugëve kombëtare	30 km	19 km
	Gjatësia e rrugëve inter-urbane	78 km	62 km
Hapësira kulturore	Hapësira e monumenteve dhe objektet e trashëgimisë kulturore	Monumentet natyrore 26 Monumentet kulturore 15 35 km rrugë Egnatia	Monumente natyrorë 8 km 4.4 km rruga Egnatia
	Hapësira e institucioneve fetare	2,051 m ²	1,426 m ²

Burimi. Strategjia e Zhvillimit të Territorit të Bashkisë Librazhd dhe Përrenjas (2017)

Pak më shumë se 50% e popullsisë janë nën moshën 40 vjeç. Migrimi është akoma në nivele të moderuara paçka se përpjesa e familjeve që janë përfitues të skemës së ndihmës ekonomike është e lartë, një tregues i varfërisë kjo e fundit, është e lartë.

Tabela 5: Tregues demografikë të zonës së studimit sipas njësisë administrative

Treguesit	Qendër Librazhd	Hotolisht	Qukës
Popullsia (nr. banorësh)	10,563	7,088	10,746
Popullsi nën moshë 40 vjeç (nr. banorësh)	5,386	3,693	5,698
Nr. familjesh	2,556	2,165	3,336
Familje me ndihmë ekonomike (%)	33.45	29.56	29.14

Pjesa e familjeve që kanë ikur nga fshati në 10 vite (përqindje)	0.45	0.32	2.4
--	------	------	-----

Burimi. Informacion i grumbulluar nga drejtuesit e njësive administrative prej WVAK

Burimet natyrore të Bashkisë Librazhd dhe Përrenjas janë burimet ujore teper të pasura me prurje gjatë gjithë stinëve të vitit, si lumi Shkumbin, lumi i Rrapunit, përroi i Gorës, i Madh, përroi i Zajes si dhe përroi i Rapunit që derdhen në lumin Rrapun. Lumi i Shkumbinit furnizohet nga pellgu i tij që ka një sipërfaqe prej 2,444 km dhe ka një gjatësi prej 181 km dhe lartësi mesatare 753 m. Si i tillë, është një lumë i rëndësishëm dhe me prurje ujore të konsiderueshme, që ndikon në zonë, si në drejtimin e vaditjes së tokave bujqësore, peshkim apo përdorim për prodhimin e energjisë elektrike.

Referuar informacioneve zyrtare të Ministrisë së Mjedisit, Rrjetit të Zonave të Mbrojtura të vitit 2014 të përgatitur nga Drejtoria e Biodiversitetit dhe Zonave të Mbrojtura, sektori i zonave të mbrojtura në territorin e bashkisë së re Librazhd përfshin:

- Parku Kombëtar Shebenik - Jabllanice, kategoria II, me sipërfaqe 33,927.7 ha - pjesë e rrjetit të zonave të mbrojtura në Shqipëri miratuar me VKM nr.640, datë 21.05.2008;
- Parku Natyror Rajonal Kuturman, kategoria IV, me sipërfaqe 3,600 ha - pjesë e rrjetit të zonave të mbrojtura në Shqipëri shpallur me Rreg. MB nr.1, datë 27.7.1977;
- Parku Natyror Rajonal Polis, kategoria IV, me sip. 45.0 ha - pjesë e rrjetit të zonave të mbrojtura në Shqipëri miratuar me VKM nr.102, datë 15.01.1996;
- Parku Natyror Rajonal Sopot, kategoria IV, me sip. 300 ha - pjesë e rrjetit të zonave të mbrojtura në Shqipëri miratuar me VKM nr.102, datë 15.01.1996;
- Parku Natyror Rajonal Dardhë - Xhyrë, kategoria IV, me sip. 400 ha - pjesë e rrjetit të zonave të mbrojtura në Shqipëri miratuar me VKM nr.102, datë 15.01.1996.

Diversiteti natyror në parqe dhe përreth tyre është shumë i pasur, si për nga flora ashtu edhe nga fauna. Parqet kanë drurë ahu, pishë e zezë, bredh, lis, mështekna, arneni, bush, ajdes, panjë, shelig, lajthi, shkozë, mëllezë, vidh, vodhëz të egër, qershi të egër, boronicë, gorricë, dardha të egër, trëndafil të egër, çaji i mali, sanza dhe më i rralli, endemiku ylli i alpeve, etj. Speciet kryesore të faunës janë: ariu i murrmë, ujku, vjedulla, dhelpra, ketri, nusja e lalës, shqiponja, skifteri, etj. Më të rrallë janë: zardafi, derri i egër, kaprolli, dhia e egër, rreqebulli, gjeli i egër, trofta e malit, etj.

Megjithëse ligjërisht janë të mbrojtura, pasuritë natyrore të Librazhdit kërcënohen vazhdimisht nga abuzimi dhe keqshfrytëzimi. Vetëm në Parkun Kombëtar Shebenik-Jabllanicë janë dhënë 45 licenca hidrocentralesh të vegjël, që sipas ambientalistëve përbëjnë një kërcënim serioz për biodiversitetin e parkut. Parku kKombëtar Shebenik- Jabllanicë përbën një ndër pasuritë e rralla natyrore dhe me biodiversitet të larmishëm në bashkinë Librazhd.

Përveç këtij parku, treva numëron edhe 26 monumente të tjera natyrore, të listuara si të kategorisë së parë. Përmendin rrugën Egnatia, Kishën e Koshorishtit, ndërtuar në një shpellë në shek. II para erës sonë; dhe distancën e shkurtër nga zona të tjera me rëndësi arkeologjike. Librazhdi dhe Përrenjasi janë pjesë e rrugëtimit të turizmit historik.

Zona ka edhe kapacitete shumë të favorshme për turizëm malor. Zona e Librazhdit shquhet për folklorin e pasur, kostumet popullore të veçanta dhe zanatin e ndërtimit të shtëpive. Kjo zonë ka kultivuar gjithashtu mjeshtrinë e përpunimit të gurit dhe të drurit. Turizmi në këtë zonë akoma është në fazat e para të zhvillimit. Vizitorët janë të pakët dhe të vetëorganizuar. Afërsia ndaj rrugës kombëtare dhe tradita prodhuese janë mundësi të zhvillimit të zonës. Ndërtimet karakteristike si psh. fshati Llangë me shtëpi karakteristike me mure guri, trekatëshe, shumëvjeçare; liqenet karstike Shebenik, liqenin e Fushë Studnes, Vlaskën, fushën e Dorëzit, Bredhin e Fushë Kuqes, Rrapin e Taksimit, Shkallën e Skënderbeut, Gurrën e Ariut, e shumë të tjera.

3.2. Vizioni dhe objektivat strategjike

Vizioni i bashkisë është zhillimi i harmonizuar urban dhe rural. Në lidhje me zhvillimin urban objektivi zhvillimor i bashkisë është si më poshtë:

- Identifikimi i hapësirave të nevojshme për vendosjen e bizneseve brenda territoreve të qytetit;
- Përcaktimi i skemës së përgjithshme të rrjetit rrugor dhe mënyrës së funksionimit me synim kryesor lehtësimin e lidhjeve nga sektori në sektor;
- Bashkërendimi i skemës së re të zhvillimit të qytetit me rrjetin e përgjithshëm të infrastrukturave (ujësjellës, kanalizime, furnizim me energji elektrike, telefoni);
- Përcaktimi i qartë të njësive strukturore të qytetit sipas të cilave do të hartohen studimet urbanistike pjesore për të gjitha pjesët e qytetit; dhe formulimit të qartë për secilën prej kushtëzimeve urbanistike, treguesve urbanistikë e shërbimeve sociale të cilat duhet të merren parasysh gjatë hartimit të studimeve urbanistike pjesore.
- Ruajtja e pejsazhit si një bashkim i elementëve antropikë e natyrorë, të organizuar sipas një skeme territoriale funksionale për zhvillimin e aktivitetit dhe për të ruajtur mjedisin në tërësinë e tij;
- Mbrojtja e burimeve natyrore dhe mjedisore që ndodhen në këto territore.

Objekti i bashkisë në lidhje me bujqësinë është të nxisë e lehtësojë aktorët lokalë për të zhvilluar zinxhirët e tyre prodhues e tregtues. Objektivat janë përmirësimi i aksesit në njohuri, metoda dhe teknologji të reja me anë të shërbimit këshillimor, lehtësimi i marrëdhënieve tregtare dhe zhvillimi i infrastrukturës së tregut si edhe mbështetja në formimin e kapitalit social me anë të zhvillimit të trajnimeve drejt grupeve të vogla të prodhimit. Me rëndësi mbetet edhe mbështetja e zhvillimit të produkteve të territorit duke kryer fushata promovuese, festime lokale dhe të tjera organizime masive.

Ekzistenca e fermave të copëzuara sjell nevojën për një aksion të përbashkët në aktivitetet bujqësore. Bashkëpunimi midis fermerëve (ose kapaciteti për të zgjidhur problemet së bashku) është shumë i ulët. Intervistat me liderat e komunitetit tregojnë një numër shumë të vogël të formave ekzistuese të bashkëpunimit kryesisht në shoqatat e përdoruesve pyjore ose shoqatat e kursim/kreditit. Ka vetëm dy shoqata fermerësh në tre njësitë administrative.

Në nivel qendror, ekzistojnë drejtori me përgjegjësi formulimin e politikave të zhvillimit rural dhe rajonal, përkatësisht Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Bashkia Librazhd janë institucione kryesore përgjegjëse që merren me orientimin e aktivitetit bujqësor të zonës. Intervistat me stafin e bashkisë dhe drejtorisë së Bujqësisë tregojnë se ato nuk mund të mbulojnë intensivisht komunat me ekspertizë dhe mbështetje.

Aktualisht departamentet e politikave dhe programimit janë shtrirë në nivel bashkie. Këto departamente kanë gjithashtu fonde dhe staf të disponueshëm (megjithatë jo të mirëtrajnuar) për projekt propozimet por kanë mungesa në kapacitete dhe mundësi të kufizuara të asistojnë njësitë administrative, çka krijon mundësi të pakta të kanalizimit të sinergjive. Njësitë administrative nuk janë akoma plotësisht të afta për të marrë përsipër projekte zhvillimore. Ato gjithashtu kanë boshllëqe financiare dhe ligjore në ekzekutimin e rolit të tyre.

3.3. Përdorimi i burimeve të bashkisë

Në zonën e studimit kryejnë aktivitetin e tyre rreth 7,000 ferma me orientim kryesisht bujqësor të cilat kanë një pronësi prej 6,000 hektarësh dhe mbarësojnë rreth 4,100 krerë gjedh e rreth 12,000 krerë të imta. Toka është shumë e përshtatshme për kultivimin bujqësor e për shkak të diversitetit të tipologjisë, ka sjellë mundshmërinë e një sërë produktesh bujqësore e blegtorale. Treguesit e mëposhtëm japin një përmbledhje të strukturave bujqësore dhe burimeve kullimore.

Tabela 6: Tregues të kapaciteteve prodhuese të zonës së studimit sipas njësive administrative

Treguesit	Qendër Librazhd	Hotolisht	Qukës
1. Sipërfaqe e tokës bujqësore në total (ha)	1,920	1,928	2,866
2. Toka bujqësore e përdorur me akses në ujitje (ha)	1,617	1,645	875

3. Sipërfaqja e kullotave (ha) nën përdorim të fshatit	162	153	175.4
4. Sipërfaqja e pyjeve nën përdorim të fshatit (ha)	114	79	4,545.8
5. Numri total i krerëve të gjedhit (krerë)	1,752	803	1,688
6. Numri total i krerëve të të imtave (krerë)	2,424	2,277	7,280
7. Mjete transporti (nr.)	32	8	30
8. Nr. traktorësh	19	25	49
9. Farmaci bujqësore (nr.)	1	0	0
10. Nr. baxhosh	4	1	0
11. Nr. restorantesh	5	16	10
12. Pika grumbullimi të produkteve bujqësore (nr.)	0	0	0

Burimi: Informacion i grumbulluar nga drejtuesit e njësive administrative prej WVAK

Nga ana tjetër ka një prevalencë në rritje të tokës së lënë djerrë si rezultat i kthimeve të pakta nga aktivitetet bujqësore, cilësisë së ulët të tokës, mungesës së aksesit në vaditje dhe emigrimit të lartë të krahut të ri të punës (grupmosha 18-39 vjeç). Zona ka kushte të mira për prodhimin e frutave, sidomos arvoreve si edhe vreshtave. Takimet me grupe prodhuesish tregojnë se fermerët kanë mbjellë tashmë blloqe me pemë të reja të mbjellura rishtas. Të dhënat e mëposhtme tregojnë qartë se numri mesatar i pemëve frutore për familje, është akoma i ulët, i mjaftueshëm kryesisht për vetëkonsum por në fshatra të caktuara. Prodhimi i rrushit është gjithashtu në nivele të larta e i destinuar për konsum vetjak, si ai i fresket ashtu dhe ai i përpunimit për raki. Prodhimi i rrushit ka potenciale të mira rritjeje megjithëse mungojnë të dhënat në lidhje me tipet e varieteteve.

Prodhimi i perimeve të freskëta tregon sasi të ulëta të disponueshme për tregun. Mundësitë për perimet e thata dhe bishtajoret tregojnë se një pjesë e fermave mund të vjelin të ardhura nga ky prodhim. Diskutime me përfaqësues të komunitetit tregojnë se cilësia e disa prej perimeve, përfshirë prodhimin e patateve është i destinuar jo vetëm për konsum vetjak por edhe për tregun lokal.

Siç duket çdo fermë ka mesatarisht një lopë apo disa krerë të imta si edhe më shumë se 20 krerë shpendë. Në zonë ka njësi përpunimi bulmeti të cilat shfrytëzojnë qumështin e gjedhit të mbarështuar dhe të tufave ekzistuese të të imtave. Pjesa më e madhe e bagëtisë për therje blihet nga tregtarët e zonës, ndërkohë që tashmë ka një thertore të rinovuar në zonë.

Tabela 7: Analiza SWOT - Sistemi bujqësor

Pikat e forta
<ul style="list-style-type: none"> • Bujqësia është një nga aktivitetet ekonomike kryesore të territorit • Klima e favorshme mundëson zhvillimin e vreshtarisë dhe pemtarisë • Tradita e kultivimit të vreshtave • Prezenca e shembujve të mirë të aktivitetit agro-turistik
Pikat e dobëta
<ul style="list-style-type: none"> • Territori i bashkisë është rreth 50% tokë bujqësore, e karakterizuar nga një cilësi e dobët toke dhe fragmentizim • Reliev i thyer dhe si pasojë kushte të vështira pune • Infrastrukturë e varfër në përgjithësi dhe bujqësore në veçanti • Kufizime të tregut • Mungesë infrastrukture ujitjeje • Mundësi të kufizuara të kredisë rurale për fermerët, përpunuesit dhe biznese të tjera të vogla rurale • Institucione të papërshtatshme, veçanërisht shërbime këshillimore jo të plota
Mundësitë
<ul style="list-style-type: none"> • Mundësi të shfrytëzimit të tokave të defavorizuara • Organizimi i fermerëve të vegjël dhe të mesëm në mënyra informale • Mundësi për zhvillimin e bujtinave dhe zhvillimin e produkteve dhe traditave ushqimore lokale
Rreziqet
<ul style="list-style-type: none"> • Emigrimi i vazhdueshëm • Mungesë e integritetit me tregjet urbane • Mungesë e mundësive të përpunimit

- Probleme në procesin e përdorimit të hapësirave në pronësi të bashkive.

Burimi: Takime me përfaqësues të komunitetit në zonat ku janë familjet përfituese të WVAK

Integrimi vertikal që rregullon lidhjen midis prodhimit në fermë dhe sektorit të përpunimit është shumë i dobët për shkak të fragmentizimit që ekziston në prodhimin e lëndës së parë veçanërisht fruta perimet dhe qumështi. Kapaciteti përpunues sigurisht është më i lartë por mbetet i pashfrytëzuar për shkak të problemeve që hasen në marrëdhëniet midis njësive përpunuese dhe ofertës së lëndës së parë (në këtë rast tepricave që rrjedhin prej prodhimit të fermave). Mungesa e besimit midis palëve, cilësia jo e qendrueshme dhe sasia e pakonsoliduar dhe jo e qendrueshme prej fermave janë disa prej problemeve kryesore.

Në zonë disponueshmëria e kullotave (mbi 400 ha) dhe e pyjeve ofron mundësi për aktivitete rurale jashtë fermës. Takimet me përfaqësues të komunitetit tregojnë se zona ka avantazhe të theksuara të prodhimit të bimëve medicinale dhe aromatike si rrjedhojë e biodiversitetit të lartë, kontakteve ekzistuese me konsoliduesit dhe kompanitë e grumbullimit, dhe forcës së lirë të punës që gjendet në popullsinë pranë terreneve malore.

Turizmi ditor është i zhvilluar por agriturizmi përveç shumë pak rasteve në zonat përreth si Stëbleva, për strehimin e turistëve që kërkojnë turizëm malor dhe disa njësive të shërbimit pranë monumenteve natyrore, akoma shumë mundësi mbeten të pashfrytëzuara. Arsyet kryesore të pamundësisë së shfrytëzimit të turizmit në këto zona janë infrastruktura e pandërtuar ende dhe mungesa e kapitalit njerëzor me njohuri të orientuara drejt pritjes së turistëve. Sipërmarrësit ekzistues kanë njohuri të kufizuara në shërbime si hoteleri dhe gastronomi.

Librazhdi ka një pozicion të favorshëm përderisa shtrihet në dy anët e rrugës kombëtare dhe shërben si një mundësi ndalese ku shërbimet për transportin mund të kombinohen shumë mirë me shërbimet e ushqimit dhe çlodhjes të cilat janë zhvilluar përgjatë viteve të tranzicionit. Megjithëse për të dyja bashkitë ku shtrihet puna e WVAK, punësimi në aktivitetin jo-bujqësor megjithë disponueshmërinë e aktiviteteve mbetet akoma i ulët. Ekonomia e bashkisë së Librazhdit është e ndarë mes shërbimeve në qytet dhe bujqësisë e blegtorisë në zonat rurale. Njësitë e shërbimit ushqimor janë më të lartat në numër, rreth 200, ndërkohë njësitë e përpunimit të industrisë së lehtë 231, bujqësia pyjet dhe peshkimi 142, ndërtimi 21, tregtia 241, transporti e magazinimi 80, informacioni e komunikacioni 8, shërbime të tjera 133, etj. Një pjesë e mirë e forcës së punës që shërben për këto aktivitete përderisa popullsia që jeton në bërthamën urbane të krijuar gjatë regjimit ekonomik të centralizuar nuk ka akses në sipërfaqe toke. Shfrytëzimi i pyjeve ka qenë gjithashtu një aktivitet tradicional dhe fitimprurës për disa biznese të zonës, por me moratoriumin u përqendrua në pak aktorë, të cilat kishin kontaktuar prej kohësh sipërfaqe të caktuara.

4. Burimet, përdorimi i burimeve dhe potencialet e zhvillimit – të dhëna parësore

4.1. Burimet e bashkisë

4.1.1. Burimet njerëzore në bashkinë Librazhd

Përmasa e familjes

Përmasa mesatare e familjes së intervistuar në Librazhd është 4.9 antarë, dhe (sipas njësive bashkiake) e vendosur në intervalin 4.8 deri në 5.1 antarë (Tabela 8). Përmasa e familjes në Librazhd duket se është pothuaj e barabartë me përmasën e familjes në zonën e projektit.

Tabela 8: Familjet e intervistuar, popullsia koresponduese dhe përmasa e familjes

Treguesit	Hotolisht	Qendër	Qukës	Librazhd	Zona e projektit
Numri i familjeve të intervistuar	27	70	14	111	439
Numri i popullsisë që i korespondon familjeve të intervistuar ⁴	131	344	72	547	2115
Përmasa mesatare e familjes	4.8	4.9	5.1	4.9	4.8

Burimi: Autorët bazuar në të dhënat e vrojtimit të strukturuar

Mosha mesatare, struktura moshore dhe raporti i varësisë

Mosha mesatare në Librazhd, 36.2 vjeç (35.5 vjeç pa vlerat ekstreme), është e më e lartë se mosha mesatare për zonën e projektit (35 vjeç, dhe 34.1 vjeç pa vlerat ekstreme) (Tabela 9) (referoju Tabela 41 në Aneks për më shumë detaje).

Tabela 9: Mosha mesatare sipas njësive administrative, bashkisë Librazhd dhe zonës së projektit

Zona e Programit	Librazhd				Zona e projektit
	Njësia Administrative			Totali	
	Hotolisht	Qendër	Qukës		
Mesatarja	36.3	35.7	38.2	36.2	35.0
Mesatarja pa vlerat ekstreme	35.4	35.3	37.7	35.5	34.1
Mediana	35.5	31.0	36.5	32.0	32.0

Burimi: Autorët bazuar në të dhënat e vrojtimit të strukturuar

Struktura e përmbledhur e popullsisë që i korespondon familjeve të intervistuar në bashkinë Librazhd, mund të karakterizohet nga tre tipare: (i) normë mesatare varësie (raporti popullsi jo në moshë pune me popullsinë në moshë pune), (ii) proporcion më të ulët të fëmijëve kryesisht krahasuar si me zonën e projektit, si dhe (iii) proporcion mesatar i popullsisë në moshë pensioni mes proporcionit të zonës së projektit dhe vendit, Tabela 10. (Për detaje të strukturës së popullsisë, referoju Tabela 41, në Aneks). Propocioni më i ulët i fëmijëve dhe relataivisht i lartë i popullsisë në moshë pensioni përban riskun e përkeqësimit të raportit të varësisë.

Tabela 10: Struktura moshore e popullsisë së intervistuar në Librazhd, zonën e projektit dhe në vend

Struktura	Struktura në %		
	Librazhd	Zona	Vendi

⁴ Diferenca mes numrit të popullsisë që i korrespondon familjeve të intervistuar dhe numrit të raportuar në tabela ose figura, përfaqëson të dhëna të munguara (missing cases).

Deri në 14 vjeç	16.4	20.6	16.8
15 deri në 64 vjeç	72.2	69.9	68.4
Mbi 65 vjeç	11.4	9.5	14.8
Totali	100	100.0	100
N	547	2016	2,845,955

Burimi: Autorët bazuar në të dhënat e vrojtit të strukturuar

Bashkia Librazhd karakterizohet nga një normë mesatare e varësisë⁵ – Norma e varësisë në Librazhd është 38 persona të varuar nga 100 vetë popullsi në moshë pune. Kjo normë varësie është qartësisht më e ulët se ajo për vendin por e barabartë zonën e projektit, respektivisht 46 dhe 38, [Tabela 11](#).

Tabela 11: Raporti i varësisë në bashkinë Librazhd, zonën e projektit dhe vendin

	Njësia administrative			Librazhd	Zona e projektit	Vendi
	Hotolisht	Njësia Qendër	Qukës			
Raporti i varësisë	55	31	53	38	38	46

Burimi: Autorët bazuar në të dhënat e vrojtit të strukturuar

Përbërja gjinore

Popullsia që i korespondon familjeve të intervistuar përbëhet nga 49% femra dhe 51% meshkuj, një strukturë në favor të meshkujve. Ky fenomen është më i theksuar në Qukës por i përmbysur në Hotolisht ku femrat dominojnë në strukturën e popullsisë, [Tabela 12](#).

Tabela 12: Struktura gjinore e popullsisë së intervistuar

Gjinia	Hotolisht		Qendër		Qukës		Totali Librazhd		Zona e projektit	
	Numër	%	Numër	%	Numër	%	Numër	%	Numër	%
Femer	69	53%	166	48%	31	43%	266	49%	993	47%
Mashkull	61	47%	177	52%	41	57%	279	51%	1117	53%
Total	130	100%	343	100%	72	100%	545	100%	2110	100%

Burimi: Autorët bazuar në të dhënat e vrojtit të strukturuar


Përbërja gjinore në bashkinë Librazhd duket ndryshon paksa nga përbërja gjinore për zonën e projektit për shkak të dominimit të meshkujve ndaj femrave.

Niveli arsimor

Arsimi deri tetëvjeçar (fillor dhe 8 vjeçar) përbën nivelin më të shpeshtë të arsimit në bashkinë Librazhd (64% e popullsisë prej që i korespondon familjeve të intervistuar ka arsim deri tetëvjeçar), proporcionin e proporcionit pothuaj i njëjtë me proporcionin me arsim deri 8 vjeçar në zonën e projektit (65%). Sipas njësive bashkiake, arsimi deri 8 vjeçar bie në intervalin 58% (Qukës) dhe 66% (Njësia Qendër).

⁵ Norma e varësisë llogaritet duke mbledhur përqindjen e fëmijëve (të moshës deri në 15 vjeç), dhe përqindjen e popullsisë në moshën e pensionit (mbi 65 vjeç), dhe kjo shumë pjestonhet me përqindjen e popullsisë në moshë pune (të moshës 15-64 vjeç). Rezultatit e shumëzoni 100, Kështu që rezultati shprehet si numër i personave të varur për çdo 100 vetë në moshë pune.

Figura 1: Struktura arsimore e popullsisë së intervistuar



Burimi: Autorët bazuar në të dhënat e vrojtimit të strukturuar

Nga ana tjetër, pjesa e popullsisë më arsim mesëm pothuaj e barabartë me atë të zonës së projektit (24% përkundrejt 25). Pjesa e popullsisë mëe arsim të lartë më e lartë krahasuar me zonën e projektit por me diferenca mes njërive bashkiake 10% në Njësina Qendër dhe 13% për Hotolisht dhe Qukës.

4.1.2. Burimet natyrore prodhuese në bashkinë Librazhd

Toka në pronësi

Sipërfaqja mesatare e tokës në pronësi për bashkinë Librazhd është 7.7 dynymë, ndërsa sipërfaqja mesatare e tokës në pronësi pa vlerat ekstreme është 7.3 dynymë. Nga të dhënat në [Tabela 13](#), del se disponibiliteti i tokës në pronësi për familje fermere të intervistuar në Librazhd është nën mesataren e zonës së projektit – sipërfaqja mesatare në pronësi dhe ajo mesatare pa ekstremet në zonën e projektit është respektivist 8.4 dhe 7.7 dynym.

Tabela 13: Të dhëna mbi tokën në pronësi

Treguesit	Librazhd				Zona e projektit
	Njësia Administrative			Total	
	Hotolisht	Qendër	Qukës		
Mesatarja	5.8	8.3	8.2	7.7	8.4
Mesatarja pa 5% vlera ekstreme	5.6	7.9	7.9	7.3	7.7
Mediana	4.2	8.0	7.5	7.0	7.0

Burimi: Autorët bazuar në të dhënat e vrojtimit të strukturuar

Toka e përdorur

Sipërfaqja mesatare e tokës së përdorur (që mund të konsiderohet si tregues përfaqësues për përmasën e fermës) për bashkinë Librazhd është 7.7 dynym, ndërsa sipërfaqja mesatare e tokës në pronësi pa vlerat ekstreme është 7.4 dynymë. Sipërfaqja mesatare e tokës së përdorur (ose përmasa e fermës) në Librazhd është qartësisht më e ulët se mesatarja për zonën e projektit, [Tabela 14](#). Ndërkaq, diferencat mes njërive bashkiake janë të rëndësishme – 6 dynym për Hotolishtin dhe 8.5 dynymë për Njësina Qendër dhe Qukësin.

Tabela 14: Të dhëna mbi tokën e përdorur

Treguesit	Librazhd			Total	Zona e projektit
	Njësia Administrative				
	Hotolisht	Qendër	Qukës		
Mesatarja	6.0	8.5	8.5	7.7	12.2
Mesatarja pa 5% vlera ekstreme	5.8	8.2	8.2	7.4	10.1
Mediana	5.0	8.0	8.0	7.0	8.0

Burimi: Autorët bazuar në të dhënat e vrojtimit të strukturuar

Tregu i qerasë

Tregu i qerasë në Librazhd është i pazhvilluar; vetëm 3 nga 11 familje (ose 3% e familjeve) raportojnë të kenë marrë tokë me qera gjatë vitit të kaluar. Nga ana tjetër, nuk raportohen familje që japin tokë me qira. Sipërfaqja totale e marrë me qira për zgjedhjen në Librazhd është vetëm 8 dynymë ndërsa për zonën e projektit 1,744.2 dynymë. Mesatarja e transaksionit për Librazhdin është 2.7 dynym, dukshëm nën mesataren zonës së projektit (13.7 dynym) (Tabela 15).

Tabela 15: Të dhëna mbi tregun e qerasë në Librazhd dhe zonën e projektit

Treguesit		Librazhd		Zona e projektit	
		Tokë dhënë me qira	Tokë marrë me qira	Tokë dhënë qira	Tokë marrë me qira
1	Familje që marrin/japin tokë më qera	0	3	15	127
2	Familje të intervistuar	111	111	439	439
3	Përqindje (1/2)*100	0%	3%	3%	29%
4	Mesatarja (Dynym)	0	2.7	6.4	13.7
5	Sipërfaqja totale (Dynym)	0	8.0	95.6	1,744.2
7	Minimumi (Dynym)	0	2.0	1.0	0.5
8	Maksimumi (Dynym)	0	4.0	15.0	130.0

Burimi: Autorët bazuar në të dhënat e vrojtimit të strukturuar


Ka raste të kufizuara të marrjes së tokës me qera kryesisht për prodhim ushqim blegtorie. Raportohet rasti i një fermeri më 40-50 dele dhe 2 lopë që merr me qera 3-4 ha tokë. Vlera e qerasë për dynym 2-3 mijë lekë të reja për dynym (20-30 mijë lekë të reja për ha) – vlera e qerasë varet nga raportet me pronarin e tokës dhe disponibilitetit të ujit. (Burimi: grupi i fokusuar)

Perceptimet e fermerëve mbi burimet më të rëndësishme natyrore prodhuese

Sipas perceptimit të fermerëve të intervistuar, burimet më të rëndësishme në bashkinë e Librazhdit (përfshirë edhe njësinë administrative Qukës) janë toka bujqësore⁶ (më shumë se dy të tretat e subjekteve të intervistuar (67.6%) vlerësojnë se toka bujqësore përbën burimin më të rëndësishëm natyror prodhues), livadhet dhe kullotat (16.2 e fermerëve konsiderojnë ato si burimin më të rëndësishëm), pyjet (9% e të intervistuarve konsiderojnë pyjet si burimin më të rëndësishëm). Peizazhet, lumenjtë e liqenet konsiderohen gjithashtu burime të rëndësishme, Figura 2.

⁶ Sipas përkufizimit të INSTAT, toka bujqësore e përdorur përfshin tokë e punëshme (arë), tokë e zënë me kultura drufrutore, kopshtet e shtëpive dhe kullotat e livadhet

Figura 2: Perceptimet e fermerëve mbi burimet natyrore në bashkinë Librazhd



Burimi: Autorët bazuar në të dhënat e vrojtimit të strukturuar

Vlerësimi për rëndësinë e tokës bujqësore të përdorur në Librazhd duket të jetë më i ulët se vlerësimi nga fermerët e zonës së projektit (67.6% e fermerëve në Librazhd vlerësojnë tokën bujqësore si burimin më të rëndësishëm përkundrejt 79% të fermerëve të zonës së projektit). Nga ana tjetër, duket qartë se kullotat janë më të rëndësishme në Librazhd se në zonën e projektit (16.2% e fermerëve të Librazhdit konsiderojnë pyjet si burimin më të rëndësishëm përkundrejt vetëm 9.3% në zonën e projektit), ndërsa pyjet janë pothuaj të së njëjtës rëndësie me zonën e projektit (9% e fermerëve në Librazhd konsiderojnë se pyjet si burimi më i rëndësishëm përkundrejt 9.3% e fermerëve të zonës së projektit). Vlerësimi pozitiv për peizazhet, liqenet dhe lumenjtë duket se janë një veçori karakteristike për bashkinë e Librazhdit.

Pjesëmarrësit në grupet e fokusuar konfirmojnë se toka bujqësore, livadhet e kullotat pyjet, peizazhet (monumentet e natyrës) dhe burimet ujore janë burimet më të rëndësishme prodhuese në bashkinë e Librazhdit.

Zona ka burime të pasura kullimore. Kullotat në territorin e bashkisë Librazhd administrohen nga Drejtoria e pyjeve. Zakonisht, blegtorët përdorin hapësira të përcaktuara kullimore në mënyrë të vazhdueshme, duke bërë kontrata të vazhdueshme me Drejtorinë Pyjore. Nuk ka pasur konflikte, sepse ka një ndarje të pranuar gjerësisht dhe kontrata është një formalitet me një kosto simbolike. Rritja e motivimit për investime do të kërkonte një marrëveshje më afatgjatë të blegtorit me Drejtorinë pyjore. Në zonën e Qukësit ka një baxho verore që blen qumësht nga fermerët e tjerë, por ka mungesa si psh mungon energji elektrike. Kanë vendosur panele diellore por sërish ka mangësi infrastrukture. Për shkak të mungesës së baxhos përgjatë gjithë viti, ka rënie të interesit në blegtori. Një kanal i rëndësishëm për fermerët e vegjël janë shitjet direkte. (Burimi: Grupi i fokusuar në Qukës dhe Librazhd)

Burimet turistike përfshirë peizazhet e monumentet e natyrës si dhe monumentet e trashëgimisë kulturore, të tilla si Rruga Egnatia, Shkëmbi i Pishkashit (lidhur me historinë e Shkënderbeut; sofa e Skënderbeut), Bërzeshta, etj. janë burime që premtojnë zhvillimin e aktiviteteve turistike. Aktualisht zhvillimi i infrastrukturës turistike është i kufizuar. Janë rreth 5 lokale që ofrojnë ushqime tradicionale, të cilat janë ditore (pa fjetje). Zona ka prodhime që janë cilësore për shkak të natyrës dhe traditës – në zonë nuk përdoren pesticide në masë. Nisur nga burimet turistike, qeveria ka listuar në Librazhd 2 fshatrat turistikë. Stëbleva është një zonë e rëndësishme potenciale për zhvillimin e turizmit. Potencial të rëndësishëm turistik përmban edhe Parku Kombëtar Shebenik-Jabllanicë. Sipas vlerësimit të përfaqësuesve të njëjësive bashkiake, monumentet e trashëgimisë kulturore konsiderohen si burimi më

i rëndësishëm prodhues në (Hotolisht), njësia bashkiake Qendër konsideron burimet ujore si burimin më të rëndësishëm, ndërsa për njësinë Qukës, peizazhet janë burimi më i rëndësishëm. Livadhet dhe kullotat konsiderohen si burimi i dytë më i rëndësishëm në Hotolisht dhe Njësinë Qendër dhe toka bujqësore si burimi i dytë më i rëndësishëm në Qukës. Pyjet janë burimi i tretë më i rëndësishëm në Hotolisht dhe Qendër dhe livadhet e kullotat në njësinë Qukës.

Si konkluzion i vlerësimit nga fermerët (intervista e strukturuar), pjesëmarrësit në grupet e fokusuar dhe përfaqësuesit e njësive bashkiake, rezultojnë se burimet më të rëndësishme janë toka bujqësore, livadhet e kullotat, pyjet dhe burimet turistike. Duhet theksuar se bazuar në informacionin cilësor (në grupet e fokusuar dhe përfaqësuesit e njësive bashkiake), burimet turistike janë shumë të rëndësishme në bashkinë e Librazhdit (përfshirë edhe njësinë bashkiake Qukës).

5. Shfrytëzimi i burimeve të bashkisë

5.1. Prodhimi në fermë

Familjet e anketuara në zonën e Librazhdit janë të orientuara drejt bimëve të arave dhe vreshtarisë. Popullata e anketuar në Librazhd kryesisht merret me aktivitete bujqësore të lidhura me kultura si perime fushe (80%), misër (72%), vreshta (52%), foragjere (50%) etj. Ndërsa të dhënat sipas njësive administrative tregojnë se njësia Hotolisht është e orientuar drejt bimëve të arave dhe arroveve (44%), kurse njësitë Qendër dhe Qukës përveç bimëve të arave orientohen dhe drejt vreshtave/kultivimit të rrushit (Tabela 16). Nga analiza e të dhënave të grumbulluara rezultojnë se mesatarisht për familjet e anketuara në Librazhd të cilat janë kultivuese të drithërave, madhësia mesatare për fermë është rreth 2 dynym respektivisht, ndërsa për foragjeret është rreth 3 dynym. Për më tepër vëmë re se sipërfaqja mesatare për fermë e frutave ekstensive është nën 1 dynym ndërsa sipërfaqja me vreshta, rreth 1.4 dynym. Kjo e fundit merr përmasa me rëndësi në Qukës, ku tejkalon sipërfaqen 4.4 dynym. Gjithashtu vëmë re se në zonë kultivohen dhe drufrutorë si aroret dhe qershia (Tabela 16). Secila nga sipërfaqet mesatare të kultivuara me produktet specifike në studim për rastin e bashkisë Librazhd janë më të vogla se mesataret e observimeve totale të studimit (zona e projektit) përveç sipërfaqes mesatare të vreshtave për fermë.

Tabela 16: Mesataret e sipërfaqeve të tokës kultivuar me produktet specifike të zonës dhe pjesa e fermerëve që prodhojnë këto produkte sipas njësive administrative dhe në total - Librazhd

Produkti	Librazhd								Zona e projektit	
	Njësia Administrative						Total			
	Hotolisht		Qendër		Qukës				Dyn/fermë	%
	Dyn/fermë*	%**	Dyn/fermë	%	Dyn/fermë	%				
Grurë	1.5	37%	2.4	24%	2.7	57%	2.2	32%	3.7	35%
Misër	1.5	59%	2.4	84%	1.4	36%	2.1	72%	2.6	64%
Perime fushe	0.4	78%	0.7	91%	0.4	29%	0.6	80%	1.1	61%
Foragjere	2.6	30%	3.1	57%	2.3	57%	2.9	50%	3.9	49%
Bimë arash të tjera	2.1	37%	2.1	24%	-	21%	2.2	27%	3.1	23%
Mollë	0.4	44%	0.7	44%	-	7%	0.6	34%	1.6	23%
Qershia	0.9	26%	1.1	33%	-	14%	1.0	29%	1.4	19%
Arrore	0.5	44%	0.3	17%	-	7%	0.4	23%	0.5	14%
Fruta të tjera	0.7	37%	1.9	13%	-	7%	0.7	18%	0.9	12%
Vreshta	0.9	49%	1.7	56%	4.4	100%	1.9	52%	1.4	30%

Shënim: *Mesatarja; **Pjesa e fermerëve që prodhojnë produktin respektiv.

Burimi: Të dhënat e grumbulluara nga anketimi

Prodhimi i grurit është rreth 9 kv për fermë, prodhimi i misrit, foragjereve dhe bimëve të tjera të arave shkon më shumë 12 kv për fermë ndërsa prodhimi i drufrutoreve varion nga 1-7 kv për fermë në varësi të frutit në Librazhd. Sa i përket prodhimit të rrushit, mesatarisht fermat në Hotolisht prodhojnë rreth 4.6 kv ndërsa në njësinë Qendër gati dyfishi i kësaj sasia (8.2 kv për fermë). Po të krahasojmë këto vlera me mesataren në nivel studimi (zona e projektit apo totali i observimeve të studimit) vëmë re se përveç foragjereve, misrit dhe vreshtave, vlerat për prodhimin bujqësor në Librazhd janë shumë më të vogla se mesatarja e totalit të studimit. Më tej, duke marrë parasysh se sasia e grurit për nevoja buke për frymë është diku 120-130 kg dhe sasia e perimeve mbi 180 kg per fryme mund të themi se aksesit në vetëpërbushje për drithëra është i arritur, ndërsa në fruta e perime është i pjesshëm ku më e mirë shfaqet situata në fruta (Tabela 17).

Tabela 17: Prodhimi (kv/fermë) i produkteve bujqësore sipas njësive dhe në total - Librazhd

Produkti	Treguesi	Librazhd				Total	Zona e projektit
		Njësia Administrative					
		Hotolisht	Qendër	Qukës			
Grurë	Prodhimi (kv/fermë)*	11.6	8.5	8.0	9.0	14.9	
	Kg/frymë	248.6	249.0	184.8	230.7	350.0	
Misër	Prodhimi (kv/fermë)*	10.8	14.3	3.4	12.9	14.4	
Foragjere	Prodhimi (kv/fermë)*	14.9	21.8	29.4	22.1	23.8	
Perime fushe	Prodhimi (kv/fermë)*	9.1	7.6	-	7.1	12.8	
	Kg/frymë	223.3	137.3	-	134.7	292.0	
Bimë arash të tjera	Prodhimi (kv/fermë)*	19.2	10.4	-	13.1	10.3	
	Kg/frymë	373.2	280.0	-	324.4	243.0	
Mollë	Prodhimi (kv/fermë)*	10.8	6.4	-	5.9	18.3	
	Kg/frymë	197.2	117.6	-	118.7	405.3	
Qershi	Prodhimi (kv/fermë)*	2.0	3.5	-	3.3	5.9	
	Kg/frymë	41.9	72.6	-	68.5	122.0	
Arrore	Prodhimi (kv/fermë)*	0.6	2.7	-	1.7	1.4	
	Kg/frymë	11.5	51.7	-	31.3	27.4	
Fruta të tjera	Prodhimi (kv/fermë)*	4.4	8.6	-	6.7	9.5	
	Kg/frymë	79.8	222.7	-	160.1	231.1	
Rrush	Prodhimi (kv/fermë)*	4.6	8.2	-	8.9	7.2	
	Kg/frymë	88.7	169.3	-	182.9	154.5	

*Mesatarja e prodhimit (kv/fermë)

Burimi: Autorët bazuar në të dhënat e vrojtit të strukturuar

Rendimenti mesatar për bimët e arave në popullatën e anketuar në Librazhd është 60.6 kv misër për ha, 82 kv foragjere për ha dhe 45.2 kv grurë për ha (Tabela 18). Këto vlera janë mesatarisht më të mëdha se mesatarja e zonës së projektit në total dhe se mesatarja në bashki.

Tabela 18: Rendimenti mesatar për bimët e arave sipas popullatës në studim dhe totali në bashki

Bima	Treguesi	Librazhd				Zona e projektit	Bashkia Librazhd Total**
		Hotolisht	Qendër	Qukës	Total		
Misër	Rendimenti (kv/ha)*	80.9	57.8	25.3	60.6	54.0	52.8
Foragjere	Rendimenti (kv/ha)*	104.5	69.3	140.5	82.0	64.2	:
Grurë	Rendimenti (kv/ha)*	84.6	34.4	28.7	45.2	41.0	39.5

Shënim: *Rendimenti mesatar; **Vjetari statistikor i Bujqësisë 2019 (INSTAT, 2020)

Burimi: Autorët bazuar në të dhënat e vrojtit të strukturuar

5.2. Prodhimi i produkteve të përpunuara në fermë

Përpunimi në fermë është një aktivitet bujqësor shumë i përhapur në njësitë administrative të anketuara në Librazhd. Rezultatet e analizës përshkruese tregojnë se një pjesë e mirë e prodhimit të përpunuar nëpër këto familje, tregtohet. Duke qenë se zona karakterizohet nga mbjelljet e perimeve, rrushit, frutave kryesisht fermerët përpunojnë në fermë verë, raki, turshi, reçel etj. Specifikisht, një fermë me vreshta në Librazhd prodhon rreth 90 litra raki ku rreth 81% e saj shitet. Në njësinë Qukës, përpunimi i rrushit në verë arrin të tregtohet në një masë prej 91% të prodhimit për fermë, ku mesatarisht një fermë me vreshta në Qukës prodhon rreth 107 litra verë. Gjithashtu një fermë prodhon mesatarisht 61 kg reçel apo produkte të ngjashme me të dhe rreth 73% e saj familjet e tregtojnë (shiko [Tabela 19](#) për përqindjet e turshive dhe produkteve të tjera të përpunuara në fermë).

Tabela 19: Prodhimi i produkteve të përpunuara në fermë, pjesa e fermerëve që prodhon dhe pjesa e shitur e prodhimeve sipas njësi administrative dhe në total

Produkti	Treguesi	Librazhd				Zona e projektit
		Njësia administrative			Total	
		Hotolisht	Qendër	Qukës		
	Totali i observimeve	27	70	14	111	439
Verë	Pjesa e fermerëve që përpunojnë	49%	56%	100%	53%	23%
	Mesatarja e prodhuar (kg)	56	95	107	92	75
	Përqindja e shitjeve	63%	70%	91%	71%	68%
Raki	Pjesa e fermerëve që përpunojnë	96%	84%	100%	89%	45%
	Mesatarja e prodhuar (kg)	22	97	117	90	87
	Përqindja e shitjeve	69%	82%	85%	81%	78%
Turshi	Pjesa e fermerëve që përpunojnë	100%	77%	100%	86%	48%
	Mesatarja e prodhuar (kg)	75	48	32	55	42
	Përqindja e shitjeve	71%	75%	:	74%	74%
Mollë të thata	Pjesa e fermerëve që përpunojnë	41%	44%	:	48%	6%
	Mesatarja e prodhuar (kg)	17	31	:	28	28
	Përqindja e shitjeve	90%	64%	:	71%	42%
Reçel e të ngjashme	Pjesa e fermerëve që përpunojnë	100%	99%	100%	99%	48%
	Mesatarja e prodhuar (kg)	46	66	45	61	40
	Përqindja e shitjeve	78%	71%	:	73%	74%
Trahana, jufka, petka etj.	Pjesa e fermerëve që përpunojnë	74%	9%	57%	31%	20%
	Mesatarja e prodhuar (kg)	15	10	10	13	13
	Përqindja e shitjeve	66%	:	:	66%	66%

Burimi: Autorët bazuar në të dhënat e vrojtimit të strukturuar

5.3. Aktivitetet blegtorale të fermës

Familjet fermere në njësitë administrative ku operon WVAK janë të diversifikuara sa i përket aktiviteteve apo nënsektorëve blegtoralë. Fermat blegtorale në njësitë e zgjedhura administrative në Librazhd janë të përfshira në aktivitete blegtorale të gjedhit (87% e të anketuarve), shpendëve (98%), bletëve (në 24% - kryesisht njësia Hotolisht) dhe të imtave (35%) ([Tabela 20](#)). Rezultatet tregojnë se 98% e fermerëve të anketuar në Librazhd kanë mesatarisht 1 lopë për fermë. Gjithashtu, një pjesë e vogël kanë të imta, ku mesatarisht një fermë të imtash ka 7 krerë dele/dhi. Ato familje që merren me mbarëshitim bletësh kanë mesatarisht 5 koshere për fermë (në njësinë Hotolisht mesatarisht 52% e familjeve kanë rreth 5 koshere për fermë) dhe 25 krerë shpendë për fermë (20 krerë një fermë në Hotolisht, 30 krerë një fermë në Qendër dhe 17 krerë një fermë në Qukës).

Tabela 20: Fermat që merren me aktivitete blegtorale dhe nr i krerëve për fermë sipas njësi administrative dhe në total për Bashkinë Librazhd

	Librazhd		Zona e projektit
	Njësia Administrative	Total (N=111)	


	Hotolisht (N=27)		Qendër (N=70)		Qukës(N=14)					
	%*	krerë/fermë**	%*	krerë/fermë*	%*	krerë/fermë*	%*	krerë/fermë*	%*	krerë/fermë**
Lopë	93%	2	86%	1	86%	1	87%	1	62%	1
Dele	15%	7	21%	8	14%	3	19%	7	11%	6
Dhi	0%	:	26%	7	0%	:	16%	7	13%	5
Shpendë	100%	20	99%	30	93%	17	98%	25	63%	21
Bletë (Koshere)	52%	5	16%	4	14%	:	24%	5	10%	6

Shënim: *Përqindja e fermave që kanë lopë/shpendë/bletë; **Nr. mesatar i krerëve për fermë.

Burimi: Autorët bazuar në të dhënat e vërtetimit të strukturuar

Gjatë 5 viteve të fundit situata lidhur me ecurinë e nënsektorëve blegtoralë (në terma të madhësisë së tufës) për bashkinë Librazhd tregohet në figurën e mëposhtme (Figura 3). Rezultatet tregojnë se madhësia e fermës në terma të numrit të krerëve gjatë 5 viteve të fundit për një pjesë të blegtorëve të të imtave ka qenë në rritje (më shumë se 16%) por gjithashtu edhe sa i përket fermave të bletëve duket se ka patur rritje për rreth 32% të tyre. Ndryshe, pjesa më e madhe e blegtorëve nuk kanë patur ndryshime të madhësisë së tufës në Librazhd (pavarësisht nënsektorit). Këto të dhëna sugjerojnë se nënsektori i bletarisë dhe të imtave janë aktivitete blegtorale në zhvillim e sipër në këtë zonë të cilat janë dhe potencial zhvillimi. Kjo rritje ka sjellë edhe në organizimin e festës së mjatit, një festë që po kthehet në traditë në zonë.


Figura 3: Ecuria e numrit të krerëve për fermat gjatë 5 viteve të fundit – Librazhd



Burimi: Autorët bazuar në të dhënat e vërtetimit të strukturuar

Për zonën e Hotolishtit specifikisht, shohim se ulja e numrit të krerëve për fermë ka ndodhur vetëm për shpendët, delet dhe lopët (shiko Figura 4). Ndërsa për bletarët, numri i koshereve ka patur rritje (42% e tyre).


Figura 4: Ecuria e numrit të krerëve për fermat gjatë 5 viteve të fundit – Njësia administrative Hotolisht



Burimi: Autorët bazuar në të dhënat e vërtetimit të strukturuar

Për fermat blegtorale në njësinë Qendër, të dhënat e grumbulluara tregojnë se për 22% të blegtorëve që mbarështojnë bletë, numri i koshereve 5 vitet e fundit është rritur. Sa i përket nënsektorëve të tjerë shiko Figura 5 mëposhtë.


Figura 5: Ecuria e numrit të krerëve për fermat gjatë 5 viteve të fundit – Njësia administrative Qendër



Burimi: Autorët bazuar në të dhënat e vërtetimit të strukturuar

Figura e mëposhtme paraqet ecurinë e numrit të krerëve gjatë 5 viteve të fundit për fermat e anketuara të njësisë administrative Qukës. Të dhënat e grumbulluara tregojnë se për blegtorët e anketuar të zonës, ecuria e numrit të krerëve të blegtorisë (pavarësisht llojit) nuk ka patur ndryshim gjatë 5 viteve të fundit (Figura 6).

Figura 6: Ecuria e numrit të krerëve për fermat gjatë 5 viteve të fundit – Njësia administrative Qukës



Burimi: Autorët bazuar në të dhënat e vërtetimit të strukturuar

5.3.1. Prodhimi i produkteve blegtorale

Blegtorët në Librazhd janë të orientuar drejt prodhimit dhe tregtimit të produkteve relative të sektorit siç janë mish i shpendëve, gjedhit, vezët dhe mjalti. Sipas analizës për njësitë administrative duket se të dhënat për prodhimin e produkteve blegtorale në fermë tregojnë se familjet fermere në njësinë administrative Hotolisht janë të orientuara kryesisht në produkte blegtorale si vezët, mjalti, mish i shpendëve dhe mish i lopës. Nga ana tjetër, blegtorët e njësisë administrative Qendër janë të diversifikuar brenda sektorit ndryshe nga të anketuarit në njësinë Qukës të cilët përveç gjedhit orientohen dhe nga prodhimi i mjaltit (në masë të vogël). Nënsektori i shpendëve (produkte si mish i shpendëve dhe vezët) janë të orientuar në treg - pra rreth 40% e blegtorëve tregtojnë më shumë se 75% të prodhimit të tyre të këtyre produkteve. Rreth 14% e fermerëve që merren me aktivitete të bletarisë tregtojnë rreth 70% të prodhimit të tyre të mjaltit. Më tej 48% e blegtorëve i shesin vicat e mëshqerrat (për më shumë referoju Tabela 21).

Tabela 21: Prodhimet blegtorale të fermës dhe pjesa e shitur e tyre sipas njësisë dhe bashkisë Librazhd në total

Produkti	Treguesi	Librazhd			Total prodhimi	Total % shitjeve ndaj prodhimit
		Prodhimi sipas njësisë administrative				
		Hotolisht	Qendër	Qukës		
	Totali i observ.	27	70	14	111	111
Mish i therur (Qingji dhe Keci kg)	Mesatare/fermë	:	109	:	102	72%
	% e vlefshme	7%	19%	0%	14%	8%
Mish i therur (viçi/lope kg)	Mesatare/fermë	86	91	:	88	76%
	% e vlefshme	41%	27%	7%	28%	19%
Mish shpendësh (kg)	Mesatare/fermë	12	29	:	25	81%
	% e vlefshme	63%	81%	0%	67%	42%
Mjaltë (kg)	Mesatare/fermë	30	52	110	44	70%
	% e vlefshme	41%	6%	14%	15%	14%
Vezë (kokrra)	Mesatare/fermë	315	878	:	713	75%
	% e vlefshme	52%	61%	0%	51%	39%

Shënim: Në rastin e prodhimit mstarja e prodhimit për fermë shprehet në kg/litra/krerë ose kokrra në rastin e vezëve. Ndërsa në rastin e pjesës së shitjeve ndaj prodhimit shprehet në përqindje. Sa i përket % së vlefshme, në rastin e prodhimit tregon % e fermerëve/blegtorëve që e prodhojnë produktin respektiv ndërsa në rastin e % së vlefshme për kolonën e pjesës së shitjeve ndaj prodhimit (kolona e fundit) tregon përqindjen e fermerëve që e tregtojnë produktin respektiv; Burimi: Përlllogaritje të autorëve bazuar në të dhënat e vërtetimit të strukturuar

5.4. Aksesimi në treg

5.4.1. Prodhimi Bujqësor

Të dhënat sugjerojnë se produktet bimore që tregtohen më së shumti nga fermerët e anketuar në Librazhd janë perimet e fushës (40% e fermerëve që tregtojnë, shesin afërsisht 23% të prodhimit të perimeve të fushës dhe frutat (14% e fermerëve që tregtojnë fruta të tjera, shesin afërsisht 40% të prodhimit të tyre kryesisht fermerët e njësisë Qendër) (shiko [Tabela 22](#)). Orientimi i fermerëve drejt tregut duket se është më i përhapur në njësinë administrative Qendër sesa në Hotolisht apo Qukës, kjo kryesisht për shkak të afërsisë me tregun urban.

Tabela 22: Shitja si përqindje ndaj prodhimit për produktet specifike të zonës dhe pjesa e fermerëve që i tregtojnë këto produkte sipas njësive administrative dhe në total për bashkinë Librazhd

Produkti	Librazhd								Zona e projektit	
	Njësia Administrative						Total			
	Hotolisht		Qendër		Qukës				Shitje/Prodhi m	%*
	Shitje/Prodhi m	%*	Shitje/Prodhi m	%*	Shitje/Prodhi m	%*				
1. Grurë	5%	26%	22%	49%	28%	36%	19%	41%	22%	32%
2. Misër	8%	63%	15%	57%	11%	79%	12%	61%	15%	58%
3. Perime fushe	17%	37%	27%	41%	21%	36%	23%	40%	28%	45%
4. Foragjere	0%	33%	15%	34%	23%	50%	12%	36%	13%	40%
5. Bimë arash të tjera	14%	30%	24%	23%	28%	36%	21%	26%	43%	22%
6. Mollë	31%	26%	42%	24%	:	:	40%	23%	46%	23%
7. Qersh	22%	26%	34%	17%	:	:	29%	17%	55%	20%
8. Arrore	19%	15%	13%	9%	:	7%	13%	10%	31%	8%
9. Fruta të tjera	:	11%	40%	16%	:	7%	40%	14%	30%	11%
10. Vreshta	:	37%	17%	33%	:	21%	9%	32%	12%	29%

Shënim: *Pjesa e fermerëve që e tregtojnë produktin respektiv (%).

Burimi: Autorët bazuar në të dhënat e vrojtimit të strukturuar

5.4.2. Prodhimi Blegtoral

Pjesa më e madhe e fermerëve shesin kafshë të gjalla. Vetëm një pjesë shesin mish të therur, kryesisht brenda fshatit. Ndërkohë shitja e shpendëve (pula dhe vezët) janë të orientuar në treg - pra rreth 40% e blegtorëve tregtojnë më shumë se 75% të prodhimit të tyre të këtyre produkteve. Rreth 14% e fermerëve që merren me aktivitete të bletarisë tregtojnë rreth 70% të prodhimit të tyre të mjaltit. Më tej 48% e blegtorëve i shesin vicat e mëshqerrat (për më shumë referoju [Tabela 21](#)).

Tabela 23: Prodhimet blegtorale të fermës dhe pjesa e shitur e tyre sipas njësive dhe bashkisë Librazhd në total

Produkti	Treguesi	Total % shitjeve ndaj prodhimit
	Totali i observ.	111
Mish i therur (Qingji dhe Keci kg)	Mesatare/fermë	72%
	% e vlefshme	8%
Mish i therur (viçi/lope kg)	Mesatare/fermë	76%
	% e vlefshme	19%

Mish shpendësh (kg)	Mesatare/fermë	81%
	% e vlefshme	42%
Mjaltë (kg)	Mesatare/fermë	70%
	% e vlefshme	14%
Vezë (kokrra)	Mesatare/fermë	75%
	% e vlefshme	39%

Shënim: Në rastin e pjesës së shitjeve ndaj prodhimit shprehet në përqindje.

Burimi: Përlllogaritje të autorëve bazuar në të dhënat e vrojtimit të strukturuar

5.5. Të ardhura të krijuara dhe burimet e të ardhurave

Kështu pra fermeret e intervistuar në zonën e studimit, jo shumë ndryshe nga ata në pjesë të tjera kodrinore malore të vendit, akoma prodhojnë në masë të madhe për vetë konsum duke diversifikuar aktivitetet tyre të mbjelljes. Intervistat me stafin e Bashkisë dhe Njësisë Administrative Qukës tregojnë se të ardhurat nga bujqësia janë akoma shumë të ulëta dhe ato mbeten vetëm një pjesë e vogël e të ardhurave totale të familjeve. Treguesit e vrojtimit vërtetojnë se rreth 89% e fermerëve të anketuar në Librazhd kanë të ardhura nga ferma, që nga ana tjetër këto të ardhura zënë mesatarisht 23% të të ardhurave të familjes. Njësia administrative Hotolisht tregon një nivel më të lartë krahasuar me njësitë e tjera sa i përket rëndësisë së të ardhurave nga ferma dhe dërgesave nga emigracioni si burime të rëndësishme të ardhurash për familjen (Tabela 24). Fermerët akoma përballen me një sërë pengesash për të zhvilluar aktivitetin e tyre bujqësor dhe shumica e tyre ka mungesë informimi dhe njohurish për përmirësimin e produktivitetit bujqësor, diversifikimin e prodhimit dhe shfrytëzimin e mundësive që paraqet tregu.

Të ardhurat nga aktivitete jashtë fermës janë burimi kryesor i të ardhurave për të anketuarit në Librazhd. Gati 99% e të anketuarve në Librazhd kanë të ardhura jashtë ferme, të cilat zënë rreth 55% të të ardhurave familjare vjetore të familjes. Pjesa aktive e popullsisë, kryesisht meshkujt, punësohen në bizneset që shtrihen në Librazhd e përgjatë rrugës kombëtare. Një pjesë tjetër angazhohen edhe duke punuar në aktivitete bujqësore në krahina të tjera të vendit, sidomos në pjesën bregdetare. Një pjesë e të ardhurave krijohen nga emigracioni. Viti aktual, për shkak të pandemisë, shënoi një vit jo të mirë meqenëse pjesa e parë e sezonit të vjeljeve në Greqi, një aktivitet ky kryesor për punësimin e zonës, nuk u shfrytëzua për shkak të kufirit të mbyllur.

Tabela 24: Të ardhurat e familjeve në përqindje sipas burimit në Librazhd dhe sipas njësive administrative

Treguesi	Librazhd				Total Librazhd	Zona e projektit
	Njësia administrative	Hotolisht	Qendër	Qukës		
	Totali i observimeve	27	70	14		
Të ardhura nga blegtoria	Pjesa e fermerëve që kanë të ardhura	82%	74%	79%	77%	58%
	% (mesatare)	12%	24%	8%	18%	33%
Të ardhura nga bujqësia	Pjesa e fermerëve që kanë të ardhura	63%	76%	71%	69%	62%
	% (mesatare)	8%	19%	17%	16%	32%
Të ardhura nga aktivitete grumbullimi	Pjesa e fermerëve që kanë të ardhura	41%	39%	:	33%	11%
	% (mesatare)	3%	5%	:	5%	5%
Totali i të ardhurave nga ferma	Pjesa e fermerëve që kanë të ardhura	93%	90%	79%	89%	85%
	% (mesatare)	19%	33%	16%	23%	51%
Të ardhura nga punësimi jashtë ferme	Pjesa e fermerëve që kanë të ardhura	67%	21%	29%	32%	34%
	% (mesatare)	31%	37%	35%	34%	44%
Pagesa nga shteti jo në formë page	Pjesa e fermerëve që kanë të ardhura	74%	81%	79%	79%	58%
	% (mesatare)	20%	27%	24%	24%	28%
Dërgesa nga emigracioni	Pjesa e fermerëve që kanë të ardhura	70%	56%	43%	58%	29%
	% (mesatare)	56%	49%	26%	49%	51%
Totali i të ardhurave nga jashtë fermës	Pjesa e fermerëve që kanë të ardhura	100%	100%	100%	99%	84%

	% (mesatare)	77%	51%	38%	55%	34%
--	--------------	-----	-----	-----	-----	-----

Shënim: Përqindjet nuk janë kulumative (100%) për zërat e të ardhurave duke qenë se përlllogaritjet janë bërë me bazë mesatare;

Burimi: Autorët bazuar në të dhënat e vrojtimit të strukturuar

Shpenzimet mujore të familjeve të anketuara në Librazhd janë rreth 38,300 lekë mesatarisht (Tabela 25) – ku për familjet në Hotolisht shpenzimet arrijnë deri në 51,050 lekë. Të anketuarit deklarojnë se diferenca mes shqenzimeve aktuale me ato të nevojshme është rreth 15,800 lekë. Më tej, një familje në Librazhd përfiton mesatarisht 58,460 lekë në muaj, ku rreth 35% të kësaj vlere, familjarët arrijnë ta kursejnë. Kjo vlerë është theksueshëm më e lartë se vlera mesatare e të gjithë zonës së projektit.

Tabela 25: Shpenzimet, të ardhurat dhe kursimet familjare mujore në secilën njësi dhe në total në Librazhd

Treguesi (lekë të vjetra në muaj për familje)	Librazhd			Librazhd Total	Zona e projektit
	Hotolisht	Qendër	Qukës		
Niveli minimal i shpenzimeve të nevojshme	56,536	53,823	53,064	54,074	44,935
Shpenzimet e realizuara aktuale	51,049	37,214	31,303	38,322	32,033
Diferenca mes shqenzimeve aktuale me ato të nevojshme	(5,487)	(16,609)	(21,761)	(15,752)	(12,902)
Të ardhurat mujore të deklaruara	71,097	55,767	48,502	58,461	45,306
Kursimet mujore të deklaruara	20,048	18,553	17,199	20,139	13,272

Burimi: Përlllogaritje të autorit bazuar në të dhënat e vrojtimit të strukturuar

Punësimi kryesor

Aktiviteti kryesor ekonomik për popullsinë që i korrespondon familjeve të intervistuar në Librazhd është punësimi në fermën e vet (37.8% e antarëve të familjes në moshë pune). Diferencat mes njërive bashkiake lidhur me punësimin në fermë janë të ndjeshme - 19% në Qukës dhe 44.5% në Njësinë Qendër. Punësimi jashtë fermës në sektorin publik dhe privat kontribuon me 7.8% të forcës së aftë punëtore (3.8% në sektorin privat dhe 4% në sektorin publik. Punësimin më të lartë në sektorin publik e privat e ka Hotolishti (14.7%) dhe më të ultin Njësia Qendër me 5.1%. Në Qukës nuk deklarohet punësim në sektorin privat. Një numër i konsiderueshëm (73 vetë ose 16.2%) deklarohet se ka emiguar mbi tre muaj brenda vitit të fundit – Hotolisht me nivelin më të lartë të emigracionit, dhe 12.2% e forcës së aftë për punë deklarohet si i papunë – Qukës me nivelin më të lartë të papunësisë. Librazhdi karakterizohet nga nivel mesatar punësimi në bujqësi dhe nivel të njëjtë krahasuar me zonën e projektit)

(Tabela 26).

Tabela 26: Aktiviteti kryesor për antarët e familjes në moshë pune

Treguesit e aktivitetit kryesor	Librazhd								Zona e projektit	
	Njësia Administrative									
	Hotolisht		Qendër		Qukës		Totali			
	Numër	%	Numër	%	Numër	%	Numër	%	Numër	%
Punon vetëm në fermën e vet	30	29.4%	130	44.5%	11	19.0%	171	37.8%	628	37.9%
Punësuar në sektorin privat	7	6.9%	10	3.4%	0	0.0%	17	3.8%	108	6.5%
Punësuar në sektorin publik	8	7.8%	5	1.7%	5	8.6%	18	4.0%	70	4.2%
Pa punë	8	7.8%	34	11.6%	13	22.4%	55	12.2%	336	20.3%
Nxënës/Student	9	8.8%	32	11.0%	8	13.8%	49	10.8%	174	10.5%
Emigracion (mbi 3 muaj)	22	21.6%	42	14.4%	9	15.5%	73	16.2%	153	9.2%
Në pension	18	17.6%	39	13.4%	12	20.7%	69	15.3%	187	11.3%
Total	102	100.0%	292	100.0%	58	100.0%	452	100.0%	1656	100.0%

Burimi: Autorët bazuar në të dhënat e vrojtimit të strukturuar

Emigrimi

Emigrimi në Librazhd është i rëndësishëm – 73 vetë deklarohet të kenë emigruar gjatë vitit të fundit. Emigrimi është kryesisht sezonal (7 nga 73 të emigruarit konsiderohen si emigrantë sezonalë). Ky është një rezultat i ngjashëm me rezultatin e zonës së projektit ku dominon emigrimi sezonal (Tabela 27).

Tabela 27: Emigrimi në Librazhd dhe zonën e projektit

	Librazhd								Zona e projektit	
	Njësia Administrative						Total			
	Hotolisht		Qendër		Qukës					
	Numër	%	Numër	%	Numër	%	Numër	%	Numër	%
Emigrim më shumë se një vit	2	9.1%	5	11.9%	0	0.0%	7	9.6%	29	19.0%
Emigrim sezonal	20	90.9%	37	88.1%	9	100%	66	90.4%	124	81.0%
Subtotal	22	100%	42	100%	9	100%	73	100%	153	100%

Burimi: Autorët bazuar në të dhënat e vrojtimit të strukturuar

Arsyet e emigrimit janë tërësisht ekonomike - 100% e atyre që kanë emigruar e kanë bërë këtë për arsye ekonomike.

Pjesëmarrësit në grupin e fokusuar vlerësojnë numri i familjeve me emigrantë sezonalë (me persona që shkojnë përkohësisht në Greqi dhe kthehen) është i konsiderueshëm, megjithëse këtë vit ka pasur mungesë emigracioni sezonal për shkak të pandemisë Covid. Emigrantët afat-gjatë vazhdojnë të dërgojnë para të afërmeve të tyre. Ka solidaritet mes anëtarëve të familjës. Duhet thënë nga ana tjetër, që nëse më parë dërgoheshim shuma të konsiderueshme për ndërtim shtëpish (dhe shumë rrallë për biznes), tani dërgohen shuma të vogla.

6. Potencialet e zhvillimit në bashkinë Librazhd

Perceptimet e fermerëve të intervistuar në Librazhd informojnë se 5 produktet potenciale më të rëndësishme janë gjedhi (31.5% e fermerëve e konsiderojnë gjedhin si aktivitetin më të rëndësishëm potencial), të imtat (15.3% e fermerëve), kultivimi i bimëve aromatike e mjekësore (BAM) (12.6% e fermerëve), pemët frutore (pa arrorët) (10.8% e fermerëve), dhe prodhimi i arrorëve (7.2% e fermerëve), [Tabela 28](#). Bletaria dhe turizmi në fermë duket vlerësohen me potenciale zhvillimi nga fermerët. (Për më shumë detaje, referoju [Tabela 42](#): Perceptimet e fermerëve mbi aktivitetin e dytë dhe të tretë potencial, në aneks).

Tabela 28: Perceptimet e fermerëve mbi produktin më të rëndësishëm potencial

Aktivitetet ekonomike	Librazhd		Zona e projektit	
	Numër	%	Numër	%
Gjedhi	35	31.5%	93	21.2%
Të imtat	17	15.3%	115	26.2%
Kultimi i BAM	14	12.6%	36	8.2%
Prodhimi i frutave (pa arrorët)	12	10.8%	77	17.5%
Prodhimi i arrorëve	8	7.2%	15	3.4%
Bletaria	7	6.3%	26	5.9%
Turizmi në fermë	6	5.4%	6	1.4%
Prodhim vere në fermë	4	3.6%	6	1.4%
Akuakultura	2	1.8%	5	1.1%
Përpunim fruta-perime në fermë	2	1.8%	7	1.6%
Tjetër	4	4%	53	12%
Totali	111	100.0%	433	98.6%

Burimi: Autorët bazuar në të dhënat e vërtetimit të strukturuar

Pjesëmarrësit në grupet e fokusuar konfirmojnë produktet të vlerësuara si më të rëndësishmet nga fermerët ([Tabela 28](#)). Ndërkaq, diskutimi në grupet e fokusuar u përqendrua në prodhimin blegtoral, prodhimin e rrushit dhe verës (grupi i fokusuar Qukës), zhvillimin e bletarisë (grupi i fokusuar në Qukës dhe Librazhd), prodhimin e arrorëve (grupi i fokusuar Qukës), dhe zhvillimin e turizmit dhe kultivimin e BAM-ve.

Në Bashkinë Librazhd, të imtat janë një aktivitet më i rëndësishëm se gjedhi. Nëse ky i fundit përdoret kryesisht për ushqimin e familjës (vetëmbajtje), të imtat janë një aktivitet më i komercializuar. Burimet kullosore dhe cilësia e kullotës e kombinuar me raca të përshtatura (Lara e Polisit, Dhia e Kostenjës, etj.) e kanë bërë Librazhdin të dallohet për “Mishin e Lunikut”. Mishi i Librazhdit është i një cilësie të lartë: “Ka raste kur një qengj Librazhdi 15 kg shkëmbehet me një qengj të një zone/race tjetër 30 kg; mishi i Librazhdit përzihet me mishra të tjerë për të rritur cilësinë”. Duhet theksuar ndërkaq se si gjedhi dhe të imtat, aktivitete tradicionale dhe të rëndësishme, janë në stanjacion ose në rënie. Ka patur iniciativa për shtimin e numrit të krerëve të lopëve “një bashkefshatari im bleu 50 lopë për të prodhuar mish viçi natyrore. Sot nuk ka asnjë lopë”. Arsye e rëndësishme e stanjacionit në gjedhë është disponibiliteti i kufizuar i tokës për prodhim foragjer. Për të mbajtur një lopë, duhen të paktën 5 dynym foragjere. Një faktor tjetër i rëndësishëm i stanjacionit në blegtori është edhe mungesa e industrisë së përpunimit në zonë, një shqetësim i ndjerë sidomos në Qukës. Në kto kushte, “fermerët kanë filluar të shesin lopët” (grupi i fokusuar Qukës).

Prodhimi i rrushit të vreshtit dhe përpunimi në verë konsiderohet si aktivitet ekonomik shumë i rëndësishëm kryesisht për njësinë bashkiake Qukës (Burimi: Grupi i fokusuar Qukës). Nisur nga kushtet e tokës dhe klimës (mikroklimë që mundëson ajrimin dhe evitimimin e sëmundshmërisë në vreshta), në zonën e Qukës vreshtat janë traditë; madje ka vreshta të trashëguara. Fshati Karkavec, zonë malore, ka pasur traditë në vreshta. Është i vetmi fshat që ka kultivuar rrushin dhe ka ende varietete autoktone. Një numër i konsiderueshëm fermerësh kultivojnë rrushin dhe prohojnë verë në kushtë shtëpie. “Kam 3 ha vresht, prodhoj deri në 5 tonë verë në kushtë shtëpie me varietetin Zaçin duke përdorur mbajtëse plastike. Verën e amballazhoj në shishe qelqi dhe shes më 300 lekë për shishe. Kam prodhuar edhe 2 kv raki që nuk e kam shitur dot” (Burimi: Grupi i fokusuar Qukës). Pesë familje që prodhojnë verë

bashkëpunojnë për të blerë bashke inpute. Kanë një presë të përbashkët, me mbështetjen e WV. Kanë formuar edhe një shoqate të vreshtarëve te Karkavecit. Fermerët e prodhimit të rrushit artikulojnë dy nevoja: (i) nevojë e një kantine vere për shitjen e rrushit ose/dhe (ii) përmirësimin e teknologjisë së prodhimit të verës në fermë. Problem mbetet tregu i rrushit ëpr ata fermerë që duan të shesin. Në zonë ka nevojë për një kantinë vere. Ka një kantinë ne librazhd, por është e vjetër dhe nuk përdor rrush lokal.

Pjesëmarrësit në grupet e fokusuar vlerësojnë se bletaria është gjithashtu një aktivitet shumë i rëndësishëm në bashkinë e Librazhdit. Vlerësohet se në këtë bashki mbarështohen 8000 koshere bletësh. Aktiviteti i prodhimit të mjaltit është më mjaft fitim pasi çmimi i mjaltit është rritur ndjeshëm duke arritur edhe deri në 2000 lekë të reja për kg. Panairët kanë qenë platformë e mirë për shitjen e produkteve lokale. Rast i veçantë është panairi i mjaltit, i organizuar nga WVAK, i cili ka qenë shumë efektiv për shitjen e produkteve dhe vendosjen e lidhjeve.

Bimët mjekësore e aromatike mund të konsiderohen gjithashtu si një burim të ardhurash. Zona ka traditë për mbledhjen e BMA-ve të egra – ka shumë familje që merren me mbledhje BAM. Ka edhe mbjellje te BMA-ve, si psh çaj mali, sherebela, etj. BAM konsiderohen gjithashtu si një produkt simbiotik (në funksion të njera tjetrës) me bletarinë. Një nga nevojat më imediate të fermerëve është nevoja për mjedise tharjeje e rrajtjeje.

Kultivimi i arrorëve, sidmos lajthisë ka një dinamikë më të shpejtë se prodhimi i rrushit. Lajthia është një bimë që përshtatet mirë, që kërkonj më pak shërbime dhe që ka një risk të ulët marketing

Nisur nga burimet turistike, turizmi përbën një potencial të rëndësishëm. Dy fshatra të bashkisë Librazhd janë përfshirë në listën e 100 fshatrave me prioritet turizmin. Aktiviteti i turizmit rural dhe turizmit në fermë është shumë i kufizuar. Një numër i kufizuar familjesh (5-6 familje) i kanë përshtatur familjet e tyre ne formë bujtinash (grupi i fokusuar Qukës).

Sipas vlerësimit të përfaqësuesve të njësive bashkiake, turizmi në fermë përfaqëson aktivitetet ekonomik më të rëndësishëm, të imtat (të dhirtat) përfaqësojnë aktivitetin ekonomik e dytë më të rëndësishëm për Hotolisht dhe Njësinë Qendër dhe frutat (kryesisht rrushi) për Njësinë Qukës dhe bleta përfaqëson produktin e tretë më të rëndësishëm për Hotolisht dhe Njësinë Qendër dhe frutat gjedhi për Njësinë Qukës.

Si konkluzion i vlerësimi nga fermerët (intervista e strukturuar), pjesëmarrësit në grupet e fokusuar dhe përfaqësuesit e njësive bashkiake, rezulton se dy aktivitetet më të rëndësishme janë ato të prodhimit blegtoral, konkretisht mbarështimi i imtave dhe gjedhit, pemët kryesisht vreshtat dhe arrorët (lajthia), bletaria, turizmi dhe BAM .

Në pikëpamje të ofertës, mungesa e fuqisë punëtore, kryesisht mungesa e moshave të reja përbën një kufizim të rëndësishëm.

7. Kapacitetet njerëzore dhe nevoja për rritjen e tyre

7.1. Vlerësimi i nevojave për rritje kapacitetesh dhe metoda e preferuar


Në këtë seksion jepet informacion i përmblodhur mbi nevojat prioritare për rritje kapacitetesh për produktet me potenciale zhvillimi, si dhe diskutohet mbi metodat e preferuara nga fermerët për rritjen e kapaciteteve.

7.1.1. Vlerësimi i nevojave prioritare për rritje kapacitetesh

Perceptimi i fermerëve të intervistuar në bashkinë Librazhd për nevojën prioritare për rritje kapacitetesh për produktin më të rëndësishëm potencial vizualizohet në Figura 7 (referoju

Tabela 26 për produktin më të rëndësishëm potencial).

Figura 7: Nevoja prioritare për rritjen e kapaciteteve për produktin prioritar



Burimi: Autorët bazuar në të dhënat e vërtetimit të strukturuar

Pesë nevojat prioritare për rritje kapacitetesh për produktin e konsideruar si produktin me potencial më të madh zhvillimi janë (i) këshillimi për perzgjedhjen e kultivarëve dhe racave të blegtorisë (54.1% e fermerëve e konsiderojnë këtë si nevojën e parë), (ii) këshillimi për përgatitjen e planeve të biznesit (dhe përgatitjen e aplikimeve) (10.8% e fermerëve), (iii) këshillimi mbi mbrojtjen e bimëve dhe kafshëve (10.8% e fermerëve), (iv) këshillimi mbi të ushqyerit e bimëve e kafshëve (8.1% e fermerëve), dhe (v) këshillim mbi marketingun - metodat e paketimit dhe marketimit (5.4% e fermerëve). Përveç konfirmimit të nevojave të mësipërme, nevojë e parë për produktin e dytë prioritar është edhe këshillimi lidhur me bashkëpunimin me blerësin (për më shumë detaje, referoju Figura 28, në Aneks).

Pjesëmarrësit në grupin e fokusuar konfirmojnë nevojat prioritare për rritjen e kapaciteteve. Zgjedhja species dhe kultivarit ose përshtatja e bimës më tokën dhe klimën konsiderohet si një nevojë e rëndësishme. Analiza e tokës është e rëndësishme (i) për të përcaktuar përshtatshmërinë e species/kultivarit me tokën kur behen mbjellje të reja, (ii) për të përcaktuar llojin e plehut dhe sasinë në funksionin të analizës së tokës dhe bimës kur bëhet plehrimi. “Mënyra se si kemi vepruar ne deri tani ka qenë provojmë për të parë se çfarë do të dalë” (Burimi: Grupi i fokusuar Librazhd). Ekspertët vlerësojnë se ka nevojë për trajnime lidhur me mbrojtjen e bimëve “Janë bërë disa trajnime për mbrojtjen e bimëve dhe kemi përfituar shumë. Trajnimet lidhur me mbrojtjen e bimëve sidomos në vreshta janë gjithnjë të nevojshme” (Burimi: Grupi i fokusuar Qukës). Trajnimet mbi shëndetin e kafshëve janë gjithashtu të nevojshme. Infeksionet (përfshirë infeksionin e gjirit) përveçse ndikojnë tek

shendetit i kafshës dhe rendimenti, krijojnë probleme lidhur me sigurinë e qumështit. Një çështje e rëndësishme për trajnimin e fermerëve është edhe trajnimi mbi riprodhimin, sidomos mbi dallimin e momentit të afshit tek lopët për të zbatuar inseminimin artificial në lopë. Ndryshimet e forta të temperaturave kanë shkatëruar sëmundjet tek bletët. Situata është përkeqësuar 2-3 vitet e fundit për shkak të ndryshimeve klimatike. (Burimi: Grupi i fokusuar Librazhd). Megjithëse lajthia konsiderohet një bimë me më pak kërkesa për teknologjinë, duke qenë se kultivimi është një fenomen i ri, fermerët kanë nevojë për një paketë të plotë teknologjike, përfshirë përshtatshmerinë e kultivarit, formimin e kurorës, plehrimin e ujtijen, etj. Një nevojë e rëndësishme për rritje kapacitetesh është edhe trajnimi mbi teknologjinë e prodhimit të verës, duke kombinuar mbështetjen me asete me teknologji prodhimi, përfshirë edhe demonstrimin në kantina të vogla (Burimi: Grupi i fokusuar në Qukës). Nisur nga potencialet për zhvillimin e turizmit dhe mungesa e njohurive në Librazhd, ka nevojë për trajnime lidhur me manaxhimin e turizmit, sipas eksperiencës së mësuar nga Lëpusha (Shkodër) (Burimi: Grupi i fokusuar Librazhd). Lidhur me BAM, fermerët kanë nevojë për këshillim për vjeljen e e përshtatshme sepse vazhdojnë të shkulin BAM me rrenjë. Nevojë artikullohet edhe për praktikën e pasvjeljes. Trajnimet lidhur me sëmundshmerinë e bletës janë gjithashtu të rëndësishme.

Sipas vlerësimit të përfaqësuesve të njësive bashkiake, nevoja më prioritare për aktivitetin më të rëndësishëm janë këshillim për zgjedhjen e kultivarëve, pra për përshtatjen më të mirë të bimës me tokën (për të tria njësitë bashkiake). Nevojat e dyta prioritare për produktin prioritar janë këshillim për plane biznesi mbi mbështetjen qeveritare (Hotolisht dhe njësia Qendër) dhe këshillim për të ushqyerit/plehrimin e bimëve, aplikimin e elementëve ushqyes sipas kërkesave të bimës dhe tokës (Qukës). Ndërsa nevojat e treta prioritare për produktin prioritar janë këshillimi financiar (Hotolisht), këshillim për mbrojtjen e bimëve (Njësia Qendër) dhe këshillim për plane biznesi mbi mbështetjen qeveritare (njësia Qukës).

Si konkluzion i vlerësimit nga fermerët (intervista e strukturuar), pjesëmarrësit në grupet e fokusuar dhe përfaqësuesit e njësive bashkiake, rezultoi se nevojat prioritare janë këshillim mbi specien dhe kultivarin si dhe të ushqyerit e bimëve bazuar në analizat e tokës, këshillim mbi mbrojtjen e bimëve, këshillim për mbrojtjen e shëndetit të kafshëve, si dhe asistencë për përfitimin nga skemat e qeverisë. Nevoja të tjera të rëndësishme për rritjen e kapaciteteve janë edhe rritje kapacitetesh për teknologjinë e prodhimit të verës, paketë teknologjike për arrorët (kryesisht lajthinë), praktikën e pasvjeljes në BAM, trajnime për manaxhimin e turizmit, riprodhimin në gjedhë dhe edukimin financiar - llogaritje kostoje.

7.1.2. Metoda e preferuar e rritjes së kapaciteteve

Metoda më e preferuar nga fermerët e intervistuar të Librazhdit është është *klasë e terren si dhe ndihma individuale (coaching)*; pothuaj 1 në 3 fermerë të intervistuar në Librazhd (32% e fermerëve) preferojnë kombinimin e klasës me terrenin, ndërsa 1 në 5 fermerë preferojnë ndihmë individuale ose në grup (Coaching). Duket qartë se fermerët në Librazhd kërkojnë njohuri praktike të transmetuara në terren dhe ndihmë individuale. Praktika në terren dhe udhëtimet studimore janë gjithashtu një metodë për tu konsideruar për rritjen e kapaciteteve (Tabela 29).

Tabela 29: Metoda e preferuar e rritjes së kapaciteteve

Metoda e rritjes së kapaciteteve	Librazhd		Zona e projektit	
	Numër	%	Numër	%
Trajnim në klasë	114	13%	398	12.7%
Praktikë në terren	149	18%	676	23.9%
Klasë dhe terren	276	32%	743	24.9%
Ndihmë individuale ose në grup (Coaching)	144	20%	644	24.4%
Udhëtime studimore	101	17%	415	14.1%
Raste të vlefshme/Përqindje	784	100%	2876	100%
Numri i mundshëm i përgjigjeve (111*11)	1221		4829	

Burimi: Autorët bazuar në të dhënat e vrojtimit të strukturuar

Nga diskutimet në grupin e fokusuar, del se udhëtimet studimore (të shkëmbimit të eksperiencës) brenda vendit për të mësuar “praktikat më të mira” të teknologjisë, mund të ishte një metodë shumë efikase për ndryshimin e mentalitetit mbi teknologjinë. “Më ka vlejtur shkëmbimi përvojave. Kam mësuar shumë nga një vizitë për mënyrën dhe kohën e spërkatjes me pesticide për të evituar problemet /dëmtimin e bletës”. (Burimi: Grupi i fokusuar në Qukës).

Praktika të testuara të mbështetjes me asete fizike në natyrë me paketa teknologjike për familjet më në nevojë mund të jenë qasje efikase për rritjen e kapaciteteve. Ofrimi i një pakete të plotë teknologjike për bimët e kultivuara rishtash krahas mbështetjes financiare vlersohet të jete një qasje e efektshme. Për shembull, në rastin e kultivimit rishtaz të arrorëve është e nevojshme që krahas ofrimit të fidanave, fermerët të asistohen më paketë të plotë teknologjike. Kombinimi i ofrimit të aseteve të vogla me paketa teknologjike mund të konsiderohet gjithashtu edhe në rastin e prodhimit të verës – fermerëve mund t’u ofrohen tankera inoksi të përshtatshëm për prodhim vere por ata duhet të asistohen gjithashtu për njohjen e teknologjisë së prodhimit të verës. Në fakt, kjo (kombinimi i mbështetjes me asete dhe paketa teknologjike) ka qenë një qasje e zbatuar tashmë nga WV.

Rritja e kapaciteteve në grupe fermerësh, sipas praktikës së deritanishme të operimit të WV, duhet të preferohet ndaj mbështetjes për individë të veçantë.

8. Ofruesi i këshillimit dhe informacionit, cilësia dhe qasja e shërbimit

8.1. Vlerësimi mbi ofruesin e këshillimit dhe informacionit, cilësinë dhe lehtësinë e qasjes

Ofruesi i këshillimit dhe informacionit

Ofruesi kryesor i këshillimit për fermerët e intervistuar në bashkinë Librazhd është konsulenca e projekteve (vlerësuar si e tillë nga 47% e fermerëve), e ndjekur qeveria lokale dhe blerësi i produktit (13% e fermerëve), **Tabela 30**. Tregtarët e inpueteve dhe drejtorja e bujqësisë përmenden gjithashtu si ofrues të rëndësishëm këshillimi (12% dhe 1% të fermerëve reciprokisht). Dallimi kryesor mes Librazhdit dhe zonës së projektit për sa i përket ofruesit kryesi të shërbimit është roli i rëndësishëm i konsulencës së projekteve.

Tabela 30: Ofruesi i këshillimit dhe informacionit

Ofruesit e shërbimit të këshillimit dhe informacionit		Zona e Programit			
		Librazhd		Total	
		Numër	%	Numër	%
Këshillim	Drejtorja e bujqësisë	93	10%	610	20%
	Qeveria lokale	119	13%	444	15%
	Universiteti	8	1%	97	3%
	Tregtari i inpueteve	105	12%	360	12%
	Blerësi i produktit	117	13%	448	15%
	Konsulent privat	33	4%	503	16%
	Konsulence projektsh	417	47%	599	20%
	Totali	892	100%	3061	100
Numri i mundshëm i përgjigjeve (106, 439*9)		963		3951	
Informacion	Drejtorja e bujqësisë	28	8%	149	14%
	Qeveria lokale	56	13%	173	13%
	Universiteti	13	3%	45	6%
	Tregtari i inpueteve	39	9%	119	12%
	Blerësi i produktit	52	12%	207	21%
	Konsulent privat	9	2%	176	17%
	Konsulence projektsh	135	52%	178	16%

	Totali	332	100%	1047	100%
Numri i mundshëm i përgjigjeve (101, 439*4)		444		1756	

Burimi: Autorët bazuar në të dhënat e vrojtitimit të strukturuar

Nga të dhënat e tabelës më sipër, bëhet e qartë se ofruesi kryesor i informacionit është gjithashtu konsulenca e projekteve (52% e fermerëve), ndjekur nga qeveria lokale (13% e të intervistuarve), blerësi i produktit (12% e fermerëve), tregtari i inputeve (9% e fermerëve) dhe drejtorja e bujqësisë (8% e fermerëve). Ashtu si edhe për këshillimin, duket se fenomeni i konsulencës së projekteve është i pranishëm edhe në ofrimin e informacionit.

Pjesëmarrësit në grupin e fokusuar konfirmojnë se ofruesit kryesorë të shërbimit të këshillimit dhe informacionit janë konsulenca e projekteve dhe qeveria lokale. Kur flitet për konsulencë projektsh nënkuptohet kryesisht WV. WV ka ofruar trajnime mbi teknologjinë e prodhimit bimor, trainime për të imtat të shoqëruar me dhënie dhe Alpine, trajnime mbi mbarëshkrimin e gjedhit, trainime për menaxhimin (përfshi analizën e kostos) si edhe shkëmbim experiencash (psh në Kosovë). Por ka ende shume nevojë për trainime teknike. Ndryshimet klimatike e bëjnë më të nevojshëm tranimin e vazhduar. Ofruesit e tjerë të shërbimit, përfshirë Drejtorinë e Bujqësisë dhe ushqumit (shërbimin ekstensiv të ministrisë së bujqësisë) janë më pak të rëndësishëm. “Librazhdi ka 52 fshatra dhe vetëm 2 specialistë të shërbimit ekstensiv që varen nga qendra rajonale në Korçë”. Media lokale ka një rol të kufizuar në evidentimin e problematikës dhe në përhapjen e praktikavë të mira.

Cilësia në këshillim

Vlerësimi për cilësinë e këshillimit është qartësisht mesatare – 6 në 10 fermerë fermerëve (60%) vlerëson se cilësia e këshillimit mesatare, 20% e konsiderojnë si të keqe e shumë të keqe dhe 10 (e konsiderojnë si të mirë dhe shumë të mirë – një shpërndarje simetrike pothuaj perfekte, [Tabela 31](#).

Tabela 31: Cilësia e këshillimit

Vlerësimi për cilësinë e shërbimit të këshillimit	Librazhd		Total	
	Numër	%	Numër	%
Shumë e keqe	51	4%	378	9%
E keqe	198	16%	1151	27%
Mesatare	740	60%	1789	42%
E mirë	213	17%	747	18%
Shumë e mirë	23	2%	179	4%
Totali	1225	100%	4244	100%
Numri i mundshëm i përgjigjeve (111, 439*13)	1443		5707	

Burimi: Autorët bazuar në të dhënat e vrojtitimit të strukturuar

Qasja në këshillim dhe informacion

Qasja në këshillim vlerësohet si e vështirë deri në mesatare - Pothuaj 4 në 10 fermerë (39%) raportojnë të kenë një qasje të vështirë në këshillim, dhe një proporcion i njëjtë (40%) vlerëson qasjen në këshillim si mesatare - një situatë paksa më pozitive krahasuar me zonën e projektit ku vetëm 31% e fermerëve vlerësojnë se qasja është mesatare ([Tabela 32](#)).

Tabela 32: Qasja në këshillim dhe informacion

Vlerësimi për lehtësinë e qasjes në shërbimin e këshillimit dhe informacionit		Zona e Programit			
		Librazhd		Total	
		Numër	%	Numër	%
Këshillim	Qasje shumë e vështirë	90	10%	625	19%
	Qasje e vështirë	348	39%	1266	39%
	Qasje mesatare	399	44%	995	31%
	Qasje e lehtë	52	6%	295	9%
	Qasje shumë e lehtë	9	1%	64	2%
	Total	898	100%	3245	100%

Numri i mundshëm i përgjigjeve (106, 439*9)		954			
Informacion	Qasje shumë e vështirë	58	17%	257	23%
	Qasje e vështirë	164	48%	475	42%
	Qasje mesatare	97	29%	266	24%
	Qasje e lehtë	18	5%	99	9%
	Qasje shumë e lehtë	3	1%	34	3%
	Total	340	100%	1131	100%
Numri i mundshëm i përgjigjeve (106, 439*4)		444		1756	

Burimi: Autorët bazuar në të dhënat e vërtetimit të strukturuar

Aksesi në informacion duket të jetë paksa më problematik – gati 1 në 2 fermerë (48%) vlerësojnë një qasje të vështirë në informacion, një vlerësim ky më negativ krahasuar me zonën e projektit.

8.2. Situata dhe mënyra e komunikimit

Mjedisi i komunikimit

Vendi i zakonshëm për diskutimet lidhur me teknologjinë e prodhimit (dhe eventualisht edhe për çështje të tjera) është qendra e fshtatit ose lagjia – Të gjithë fermerët e intervistuar (100% e të intervistuarve) konsiderojnë lagjen si vendin e zakonshëm për diskutime teknike dhe 96% e të intervistuarve konsiderojnë fshatin si vendin e diskutimeve teknike. Kjo tendence konfirmohet edhe në nivelin e zonës së projektit. Njësia administrative është gjithashtu një mjedis i rëndësishëm komunikimi ndërsa bashkia dhe bashkia duket se konsiderohet si më distante për fermerët në pikëpamje të diskutimeve teknike, [Tabela 33](#).

Tabela 33: Mjedisi ku komunikohet për teknologjinë e prodhimit

Mjedisi i komunikimit për teknologjinë		Zona e Programit			
		Librazhd		Zona e projektit	
		Numër	%	Numër	%
Diskutimi për teknologjinë bëhet në bashki	Jo	72	67.9%	323	79.4%
	Po	34	32.1%	84	20.6%
	total	106	100.0%	407	100.0%
Diskutimi për teknologjinë bëhet në njësinë administrative	Jo	26	23.4%	244	59.2%
	Po	85	76.6%	168	40.8%
	total	111	100.0%	412	100.0%
Diskutimi për teknologjinë bëhet me njëri-tjetrin në qendrën e fshatit	Jo	4	3.6%	52	12.0%
	Po	107	96.4%	382	88.0%
	total	111	100.0%	434	100.0%
Diskutimi për teknologjinë bëhet me njëri-tjetrin në lagje	Jo	0	0.0%	23	5.3%
	Po	109	100.0%	410	94.7%
	total	109	100.0%	433	100.0%

Burimi: Autorët bazuar në të dhënat e vërtetimit të strukturuar

Pandemia dhe komunikimi

Duket se pandemia ka patur një ndikim të rëndësishëm në intensitetin e komunikimit. Më shumë se 4 në 5 fermerë (ose 82%) shprehen se pandemia ka penguar komunikimin. Pandemia ka prekur lëvizshmërinë Librazhd më shumë se në gjithë zonën e projektit. Pandemia duket se ka prekur institucionin më të rëndësishëm të marrjes së informacionit dhe zgjidhjes së problemeve - kafenenë në qendër të fshatit (96.4% e fermerëve e kanë ndjerë këtë mungesë) ([Tabela 34](#)).

Tabela 34: Ndikimi i pandemisë në intensitetin e komunikimit

Ndikimi i pandemisë në levishmëri dhe komunikim		Librazhd		Total	
		Numër	%	Numër	%
A ju ka penguar pandemia në vajtjen në: Bashki	Jo	29	26.9%	103	25.0%
	Po	79	73.1%	309	75.0%

	total	108	100.0%	412	100.0%
A ju ka penguar pandemia në vajtjen: Në njësi administrative	Jo	5	4.5%	117	28.1%
	Po	106	95.5%	299	71.9%
	total	111	100.0%	416	100.0%
A ju ka penguar pandemia në vajtjen në: Me njëri tjetrin në kafene/qendër fshati	Jo	4	3.6%	169	38.9%
	Po	107	96.4%	265	61.1%
	total	111	100.0%	434	100.0%
A ju ka penguar pandemia në vajtjen në: Me njëri tjetrin në shtëpi në lagje	Jo	39	35.5%	251	58.1%
	Po	71	64.5%	181	41.9%
	total	110	100.0%	432	100.0%
Total	Jo	77	18%	640	38%
	Po	363	82%	1054	62%
	total	440	100%	1694	100%
Numri i mundëshëm i përgjigjeve (111, 439*4)		444		1756	

Interneti si mënyrë komunikimi

Interneti është mënyrë e rëndësishme e komunikimit të fermerëve me specialistët për marrjen e informacionit lidhur me teknologjinë dhe tregjet: më shumë se 4 në çdo 10 fermerë (44%) të Librazhdit përdorin internetin për zgjidhjen e problematikave të fermës. Nga të dhënat duket interneti përdoret më shumë për aspekte të këshillimit mbi teknologjinë e prodhimit dhe më pak marrjen e informacionit lidhur me inputet (Tabela 35).

Tabela 35: Interneti si mënyrë komunikimi për infomacion mbi teknologjinë e tregjet

Çështjet	Librazhd		Total		
	Numër	%	Numër	%	
Përdorimi i internetit për informacion për teknologji prodhimi dhe shëndetit të bimeve ose kafshëve	Jo	44	39.6%	229	52.6%
	Po	67	60.4%	206	47.4%
	total	111	100.0%	435	100.0%
Përdorimi i internetit për të grumbulluar informacion për çmimet dhe informacion për tregun	Jo	65	58.6%	277	63.8%
	Po	46	41.4%	157	36.2%
	total	111	100.0%	434	100.0%
Përdorimi i internetit për të marrë informacion për inputet dhe pajisjet	Jo	72	65.5%	281	64.6%
	Po	38	34.5%	154	35.4%
	total	110	100.0%	435	100.0%
Përdorimi i internetit për të komunikuar për problemet e fermës tuaj me specialistë ose të tjerë	Jo	64	59.3%	271	62.6%
	Po	44	40.7%	162	37.4%
	total	108	100.0%	433	100.0%
Total	Jo	245	56%	1058	61%
	Po	195	44%	679	39%
	total	440	100%	1737	100%
Numri i mundëshëm i përgjigjeve (111, 439*4)		444		1756	

9. Partnerët e zhvillimit për ofrimin e shërbimeve të këshillimit dhe informacionit

9.1. Partnerët e zhvillimit

Pesë partnerët më të rëndësishëm të zhvillimit në Librazhd (renditur sipas numrit të përgjigjeve pozitive) janë njësia bashkiake (96.4% e intervistuarve e konsiderojnë njësinë bashkiake si partner të rëndësishëm), shkolla profesionale (68.5% e të intervistuarve), bleresit e produkteve (45.9% e të

intervistuarve), drejtoria e bujqësisë (45.9% e të intervistuarve), Listohet edhe një “partner tjetër” (38.7% e të intervistuarve). Tregtarët e inuteve me (37.8% e të intervistuarve), Agjencia e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural (AZHBR) (12.6% e të intervistuarve), janë gjithashtu partnerë për tu konsideruar (Tabela 36).

Tabela 36: Partnerët e zhvillimit në Librazhd dhe zonën e projektit

	Librazhd		Zona e projektit	
	Numër	%	Numër	%
Njësia bashkiake	107	96.4%	200	45.9%
Shkolla profesionale	76	68.5%	84	19.3%
Blerësit e produkteve	51	45.9%	169	38.8%
Drejtoria e Bujqësisë	51	45.9%	140	32.1%
Tjetër	43	38.7%	116	26.6%
Tregtarë inuteve	42	37.8%	131	30.0%
AZHBR	14	12.6%	50	11.5%
Agjenci Zhvillimi	3	2.7%	10	2.3%

Burimi: Autorët bazuar në të dhënat e vrojtimit të strukturuar

Zëri tjetër i korespondon kryesisht WVAK, si për Librazhdin ashtu edhe për zonën e projektit.

Kur flitet për shkollën profesionale, fermerët i referohen qendrës profesionale që ofron kurse profesionale për berber, hidraulik, elektrikist, riparim televizorash etj. Një numër të rinjsh janë përgatitur në këtë qendër profesionale.

9.2. Kapaciteti i partnerëve

Kapaciteti partnerëve kryesorë për ofrimin e shërbimeve të këshillimit dhe informacionit si mesatar – më shumë se 4 në 10 fermerë të intervistuar (42% e fermerëve) vlerësojnë se kapacitetet e partnerëve janë mesatare. Rreth 1 në çdo 3 fermerë vlerëson se kapacitetet e fermerëve janë të ulëta dhe shumë të ulëta dhe vetëm afro 1 në çdo 4 fermerë (24%) vlerëson se kapacitetet janë të larta e shumë të larta. Vlerësimet për kapacitetet e partnerëve janë dukshëm më të larta se për zonën e gjithe projektit (Tabela 37).

Tabela 37: Perceptimi mbi kapacitetet e partnerëve për ofrimin e këshillimit dhe informacionit

Kapacitetet e partnerëve	Librazhd		Zona e projektit	
	Numër	%	Numër	%
Shumë të ulta	147	20%	937	33%
Të ulta	101	14%	637	22%
As të ulta, as të larta	313	42%	838	29%
Të larta	155	21%	367	13%
Shumë të larta	25	3%	89	3%
Subtotal	741	100%	2868	100%
Numri i mundshëm i përgjigjeve (111, 439*8)	888		3512	
Të ulta e shumë të ulta	248	33%	1574	54.9%
Të larta e shumë të larta	180	24%	456	15.9%

Burimi: Autorët bazuar në të dhënat e vrojtimit të strukturuar

Fermerët e Librazhdit kanë një vlerësim shumë më pozitiv për kapacitetet e blerësve të produkteve, shkollave profesionale dhe tregtarëve të inuteve. Vlerësim të mirë ka edhe për njësinë bashkiake dhe AZHBR.


10. Efektet e pandemisë Covid-19 mbi funksionimi e zinxhirëve të vlerës dhe sigurinë ushqimore

10.1. Efektet e pandemisë Covid-19 mbi funksionimi e zinxhirëve të vlerës

Ashtu sikurse u tregua edhe në seksionin një pjesë e vogël e prodhimit blegtoral në njësitë administrative të përfshira në studim dhe një pjesë pak më e koniderueshme e prodhimit bujqësor (mbi 40%) janë të destinuara për treg. Duke qenë se vetëm rreth 33% e fermerëve u janë përgjigjur pyetjeve për mundësinë e të punuarit përgjatë periudhës kulmore të pandemisë dhe duke qenë se pjesa më e madhe e tyre kanë ndjekur punët, sidomos në mbjellje foragjeresh dhe punë toke, vërejmë se problemi më i zakonshëm i hasur për ato pak persona që kanë deklaruar pengesa (64 persona në të gjithë zonën e projekti) është pamundësia për të blerë mekanikë, farë apo plehra për mbjellje. Nga pyetjet e kryera në lidhje me krahasimin e shitjeve përgjatë periudhës mars e prill, në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, përgjigjet variojnë sipas llojit të produktit.

Vlera e shitjeve gjatë vitit 2020 për produktet specifike siç janë bimët e arave (grurë, misër, foragjere, perime fushe apo të tjera) të cilat përgjithësisht tregtohen nga prodhuesit në Librazhd (total bashkia) krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2019 sipas të anketuarve ka rënë. Për shembull, për 60% të tregtuesve të foragjereve, për 59% të tregtuesve të misrit dhe 54% të tregtuesve perimeve vlera e shitur për këto produkte ka rënë gjatë vitit 2020 krahasuar me vitin 2019. Megjithatë një pjesë e mirë e tyre nuk ka patur ndryshime të dukshme për shembull përmendim grurin dhe bimët e tjera të arave (përveç të listuarat) - për 67% të tregtuesve të grurit dhe 79% të tregtuesve të bimëve të tjera të arave nuk ka patur ndryshim në vlerën e shitur të prodhimit gjatë vitit 2020 (shiko Figura 8).

Figura 8: Ecuria në vlerën e shitjeve të produkteve bujqësore krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2019 – Total Librazhd




Shënim: Për përqindjet e observimeve të vlefshme shiko Tabela 22;

Burimi: Autorët bazuar në të dhënat e vërtetimit të strukturuar

Rezultatet për njësinë administrative Hotolisht, tregojnë se ecuria e vlerës së shitjes në vitin 2020 për produkte si misri, gruri, perime fushe dhe foragjere për shumicën e prodhuesve ka qenë e njëjtë krahasuar me vitin 2019. Nga ana tjetër, 30% e tregtuesve të perimeve të fushës në Hotolisht kanë përjetuar ulje të vlerës së shitjeve në vitin 2020 krahasuar me 2019 për këtë produkt (Figura 9).


Figura 9: Ecuria në vlerën e shitjeve të produkteve bujqësore krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2019 - Hotolisht



Shënim: Për përqindjet e observimeve të vlefshme shiko [Tabela 22](#);
Burimi: Autorët bazuar në të dhënat e vërtetimit të strukturuar.

Për rastin e njësisë Qendër, rezultatet e analizës përshkuese tregojnë se për shumicën e prodhuesve të këtyre produkteve në këtë njësi ecuria e vlerës së shitjeve të prodhimeve të tyre ka qenë mesatarisht në rënie krahasuar me vitin 2019. Për shembull 81% e tregtuesve të foragjereve, 77% të tregtuesve të misrit dhe 69% e tregtuesve të perimeve të fushës kanë patur ulje sa i përket vlerës së shitur krahasuar me po të njëjtën periudhë të vitit të kaluar (Figura 10).


Figura 10: Ecuria në vlerën e shitjeve të produkteve bujqësore krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2019 – Qendër



Shënim: Për përqindjet e observimeve të vlefshme shiko [Tabela 22](#);
Burimi: Autorët bazuar në të dhënat e vërtetimit të strukturuar

Për rastin e njësisë administrative Qukës rezultatet tregojnë një situatë më të disfavorshme. Për shumicën e prodhuesve dhe tregtuesve të grurit, misrit dhe bimëve të tjera të arave vlera e shitjeve ka pësuar ulje krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2019 (Figura 11).


Figura 11: Ecuria në vlerën e shitjeve të produkteve bujqësore krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2019 - Qukës



Shënim: Për përqindjet e observimeve të vlefshme shiko [Tabela 22](#);
Burimi: Autorët bazuar në të dhënat e vërtetimit të strukturuar

Pavarësisht se situata për secilën njësi administrative në veçanti tregon specifika më të detajuara, siç do shpjegohet në figurat pasardhëse, [Figura 12](#) më poshtë paraqet situatën në bashkinë Librazhd në total. Sipas të dhënave të grumbulluara, për shumicën e fermerëve situata në vitin 2020 duke e njëjtë me atë të kësaj periudhe në vitin 2019, në terma të vlerës së shitur të produkteve blegtorale. Megjithatë pjesa e fermerëve që kanë pësuar ulje të vogla mbetet jo e konsiderueshme. Veçojmë rastin e mishit të shpendëve dhe vezëve, ku mbi 57% e të anketuarve që i janë përgjigjur pyetjes kanë patur ulje të vlerës së shitur të këtyre produkteve blegtorale. Gjithashtu ulje të vogla në vlerën e shitjes blegtorale kanë patur dhe për produktet e nënsektorit të të imtave (mish apo qumësht) (për më shumë shiko figurën e mëposhtme). Shitjet në rënie të raportuara nga të intervistuarit mund të vijnë si pasojë e një orientimi më të ulët nga tregu ose si pasojë e kufizimit të lëvizjeve në javën e parë dhe të dytë të pandemisë. Për këtë të dytën nuk ka frekuencë të majftueshme të përgjigjeve.

Figura 12: Ecuria në vlerën e shitjeve të produkteve blegtorale krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2019 - Librazhd




Shënim: Për përqindjet e vlefshme (nr. e observimeve dhe pjesën ndaj totalit) shiko [Tabela 43](#) në Aneks;
Burimi: Autorët bazuar në të dhënat e vërtetimit të strukturuar

Sipas rezultateve, shumica e blegtorëve të anketuar në njësinë Hotolisht, deklarojnë se të ardhurat e tyre nga shitja e produkteve blegtorale krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2019 janë të njëjta. Më tej,

për shitjet e produkteve si mish i gjedhit, gjedhi i shitur si peshë e gjallë, mish i shpendëve dhe vezët të ardhurat kanë pësuar ulje për rreth 1/3 e blegtorëve (referoju Figura 13).


Figura 13: Ecuria në vlerën e shitjeve të produkteve blegtorale krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2019 - Hotolisht



Burimi: Autorët bazuar në të dhënat e vërtetimit të strukturuar

Sipas rezultateve, situata për njësinë Qendër duket më negative se në Hotolisht. Shumica e blegtorëve të anketuar në këtë njësi, deklarojnë se kanë patur ulje të të ardhurave të tyre nga shitja e produkteve blegtorale krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2019 (referoju Figura 14).


Figura 14: Ecuria në vlerën e shitjeve të produkteve blegtorale krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2019 - Qendër



Burimi: Autorët bazuar në të dhënat e vërtetimit të strukturuar

Njësia Qukës, duke qenë se prodhon sasi shumë të vogla të këtyre produkteve ose nuk prodhon krahasimisht gjendet në një situatë të ngjashme me një vit më parë, duke rezultuar kështu për shumicën e blegtorëve të përgjigjur në të ardhura nga shitja njësoj me të njëjtën periudhë të vitit 2019 (referoju Figura 15).

Figura 15: Ecuria në vlerën e shitjeve të produkteve blegtorale krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2019 - Qukës



Burimi: Autorët bazuar në të dhënat e vërtetimit të strukturuar

10.2. Efekti i pandemisë tek të ardhurat mujore familjare

Tabela dhe figurat pasardhëse paraqesin rezultatet përshkruese sipas njësive administrative dhe në total për bashkinë Librazhd mbi uljen e të ardhurave familjare si shkak i pandemisë (për secilën kategori të të ardhurave). Të dhënat në [Tabela 38](#) më poshtë tregojnë se në njësitë administrative të Librazhdit të ardhurat nga blegtoria kanë pësuar ulje për shkak të pandemisë për shumicën e familjeve (74% e familjeve me të ardhura nga blegtoria), ndërsa 89% e familjeve me të ardhura nga bujqësia (të cilat përbëjnë mesatarisht 65% të totalit të familjeve në Librazhd) kanë pësuar ulje në këto të ardhura për shkak të pandemisë. Të ardhurat me burim dërgesat nga emigracioni është një tjetër kategori të ardhurash që ka pësuar ulje për shkak të pandemisë (më e dukshme dhe më e përhapur në njësinë Hotolisht). Kjo njësi është edhe ajo më pranë tregut urban, e si pasojë edhe më e prekshme ndaj ndryshimeve të konsumatorit final.

Tabela 38: Ndryshimi i të ardhurave sipas kategorive për shkak të pandemisë për familjet në Librazhd (dhe sipas njësive administrative)

Njësia Adm.	Ulja për shkak të pandemisë	Të ardhurat nga blegtoria	Të ardhura t nga bujqësia	Të ardhurat nga aktivitetet grumbullimi	Të ardhura totale nga ferma	Të ardhura nga punësimi jashtë ferme	Pagesa nga shteti jo në formë page	Dërgesa nga emigracioni	Totali i të ardhurave nga jashtë fermës
Hotolisht	Jo	40%	20%	27%	28%	56%	90%	5%	15%
	Po	60%	80%	73%	72%	44%	11%	95%	85%
	%*	74%	56%	41%	67%	59%	70%	74%	48%
Qendër	Jo	22%	10%	13%	33%	15%	90%	24%	62%
	Po	78%	90%	87%	67%	85%	10%	77%	38%
	%*	71%	70%	33%	30%	19%	44%	49%	30%
Qukës	Jo	17%	0%	100%	0%	0%	10%	0%	0%
	Po	83%	100%	0%	100%	100%	90%	100%	100%
	%*	86%	57%	7%	29%	29%	71%	43%	43%
Total Librazhd	Jo	26%	11%	20%	28%	33%	77%	15%	38%
	Po	74%	89%	80%	72%	67%	23%	85%	63%
	%*	74%	65%	32%	39%	30%	54%	54%	36%


Shënim: %* e observimeve të vlefshme;

Burimi: Autorët bazuar në të dhënat e vërtetimit të strukturuar

Për të parë situatën e ndryshimit (përkatesisht uljes) të të ardhurave në nivel bashkie shiko [Figura 16](#). Rezultatet e analizës përshkruese ashtu si u përmend dhe më lart, tregojnë se dhe në nivel bashkie të ardhurat që kanë pësuar më shumë ulje prej pandemisë për shumicën e familjeve janë të ardhurat nga ferma (për 80% të të anketuarve – por sidomos të ardhurat bujqësia – 89%) dhe dërgesat nga emigracioni

(85%). Por nuk duhet të lemë pa përmendur dhe të ardhurat e tjera të cilat (përveç pagesave nga shteti jo në formë page) kanë pësuar ulje prej pandemisë për shumicën e të anketuarve.


Figura 16: Përgjigjet e pyetjes “A kanë pësuar këto të ardhura ulje për shkak të pandemisë?” - Librazhd



Burimi: Autorët bazuar në të dhënat e vrojtimit të strukturuar

Nëse do të analizojmë të dhënat në bazë njësie administrative, vëmë re se në njësinë administrative Hotolisht të ardhurat që kanë pësuar ulje për shkak të pandemisë sipas shumicës së të anketuarve janë së pari dërgesat nga emigracioni – 95% e të anketuarve në Hotolisht konfirmojnë se ulja e këtij burimi të ardhurash ka ardhur si pasojë e pandemisë dhe së dyti të ardhurat nga bujqësia – pra aktivitetet bujqësore nga të cilat shumica e të anketuarve varen si burim të ardhurash kanë pësuar ulje si shkak i pandemisë. Por gjithashtu dhe burimet e tjera të të ardhurave për shumicën janë ndikuar nga pandemia – referoju Figura 17 më poshtë.

Figura 17: Përgjigjet e pyetjes “A kanë pësuar këto të ardhura ulje për shkak të pandemisë?” – Hotolisht




Burimi: Rezultatet nga anketimi

Për familjet e intervistuar në njësinë adm. Qendër, për shkak të pandemisë të ardhurat që pësuan ulje sipas rëndësisë janë të ardhurat nga bujqësia (për 90% të anketuarve), të ardhurat nga punësimi jashtë

fermës (për 85% të të anketuarve), të ardhurat nga aktivitete grumbullimi (për 87% të të anketuarve) etj. (për më shumë shiko Figura 18).


Figura 18: Përgjigjet e pyetjes “A kanë pësuar këto të ardhura ulje për shkak të pandemisë?” – Qendër



Burimi: Autorët bazuar në të dhënat e vrojtimit të strukturuar

Të dhënat për rastin e njësisë administrative Qukës tregojnë se për shumicën e familjeve të anketuara të ardhurat si nga ferma ashtu dhe jashtë fermës kanë pësuar ulje për shkak të pandemisë (Figura 19).

Figura 19: Përgjigjet e pyetjes “A kanë pësuar këto të ardhura ulje për shkak të pandemisë?” - Qukës




Burimi: Autorët bazuar në të dhënat e vrojtimit të strukturuar

10.3. Efektet e pandemisë Covid-19 mbi sigurinë ushqimore të familjeve

Niveli i vështirësisë në konsumin e produkteve bujqësore dhe blegtorale përgjatë muajve mars-prill për shumicën e familjeve të anketuara në Librazhd, duket mesatarisht disi i vështirë përveç rastit të qumështit dhe nënprodukteve të tij dhe vezëve. Nga ana tjetër 51% e të anketuarve deklarojnë se e kanë patur shumë të vështirë konsumin e produkteve të paketuara si makarona, oriz apo vaj (shiko Figura 20).


Figura 20: Shkalla e vështirësisë për konsumin e ushqimeve të mëposhtme përgjatë muajit mars-prill – Librazhd



Burimi: Autorët bazuar në të dhënat e vërtetimit të strukturuar

Familjet e anketuara në njësinë administrative Hotolisht specifikisht, ndryshe nga rezultatet në total që u përshkruan më lart tregojnë se përveç produkteve të paketuara që konsumatorët përgjithësisht i blejnë, kanë patur vështirësi në konsumin e produkteve të bulmetit dhe mishit përgjatë muajit mars-prill. Më tej, 12% e familjeve e kanë patur shumë të vështirë aksesin në produkte si fruta dhe perime (shiko Figura 21).


Figura 21: Shkalla e vështirësisë për konsumin e ushqimeve të mëposhtme përgjatë muajit mars-prill – Hotolisht



Burimi: Autorët bazuar në të dhënat e vërtetimit të strukturuar

Sipas rezultateve, ngjashmërisht me totalin e observimeve në Librazhd shumica e familjeve të anketuara në njësinë Qendër e kanë patur shumë të vështirë konsumimin e ushqimeve të paketuara si makarona, oriz apo vaj përgjatë muajit mars-prill (63%). Ndërkohë, 23% e familjeve në këtë njësi e kanë patur shumë të vështirë aksesin në produktet e drithërave (Figura 22).


Figura 22: Shkalla e vështirësisë për konsumin e ushqimeve të mëposhtme përgjatë muajit mars-prill – Qendër



Burimi: Autorët bazuar në të dhënat e vërtetimit të strukturuar

Ndërsa në njësinë administrative Qukës duket se shumica e familjeve e kanë patur disi të vështirë konsumin e produkteve blegtorale dhe bujqësore përgjatë muajit mars-prill. Sipas rezultateve, 100% e familjeve e kanë patur disi të vështirë konsumin e vezëve dhe produkteve të bulmetit (Figura 23).

Figura 23: Shkalla e vështirësisë për konsumin e ushqimeve të mëposhtme përgjatë muajit mars-prill – Qukës



Burimi: Autorët bazuar në të dhënat e vërtetimit të strukturuar

Për të parë sa përqind të produkteve si fruta, perime, vezë apo mish vetëprodhojnë familjet në secilën njësi administrative por dhe në Librazhd total shikoni tabelën vijuese. Duket se ka një lidhje të drejtpërdrejtë midis aftësisë vetëprodhuese dhe vështirësisë për të konsumuar një produkt të caktuar. Konkretisht, në Hotolisht vetëm 50% e fermerëve arrijnë të vetëprodhojnë produkt bulmeti, e si pasojë pjesa më e madhe e tyre vuajtën aksesin ndaj këtij grupi produktesh përgjatë periudhës së pandemisë.


Tabela 39: Përgjigjet e pyetjes “Sa përqind të këtyre produkteve arrini ti prodhoni në fermën tuaj”

Produkti	Bashkia	Librazhd				Zona e programit
	Njësia Administrative	Hotolisht	Qendër	Qukës	Total	
	Totali i observimeve	27	70	14	111	
Fruta	Pjesa e fermerëve që arrijnë të vetëprodhojnë	52%	80%	71%	72%	68%
	Mesatarja e vetëprodhimit të mundshëm (%)	53%	43%	12%	41%	39%
Perime	Pjesa e fermerëve që arrijnë të vetëprodhojnë	48%	81%	71%	72%	71%
	Mesatarja e vetëprodhimit të mundshëm (%)	47%	41%	9%	37%	40%
Drithëra	Pjesa e fermerëve që arrijnë të vetëprodhojnë	48%	71%	64%	65%	67%
	Mesatarja e vetëprodhimit të mundshëm (%)	37%	36%	28%	34%	42%
Mish	Pjesa e fermerëve që arrijnë të vetëprodhojnë	52%	84%	79%	76%	68%
	Mesatarja e vetëprodhimit të mundshëm (%)	87%	55%	12%	55%	39%
Qumësht e produkte bulmeti	Pjesa e fermerëve që arrijnë të vetëprodhojnë	52%	84%	79%	76%	75%
	Mesatarja e vetëprodhimit të mundshëm (%)	100%	93%	33%	87%	71%
Vezë	Pjesa e fermerëve që arrijnë të vetëprodhojnë	48%	86%	93%	77%	70%
	Mesatarja e vetëprodhimit të mundshëm (%)	100%	96%	15%	86%	72%

Burimi: Autorët bazuar në të dhënat e vrojtimit të strukturuar

Në total në Librazhd, 62% e familjeve të anketuara kanë deklaruar se janë “pak të shqetësuar” nëse do të jenë në gjendje të sigurojnë për veten dhe familjen ushqim dhe artikujt bazë gjatë 2 muajve të ardhshëm (specifikisht sipas njësive administrative: 93% në Hotolisht, 63% në Qendër). Ndërsa 100% e familjeve në njësinë Qukës (të anketuara) kanë deklaruar se janë “shumë të shqetësuar” nëse do të jenë në gjendje të sigurojnë ushqim dhe artikujt bazë për familjen gjatë 2 muajve të ardhshëm (0% në Hotolisht dhe 36% në Qendër), Figura 24.


Figura 24: Rezultatet e pyetjes “Sa i/e shqetësuar jeni nëse do të jeni në gjendje apo jo të siguroni për veten dhe familjen tuaj ushqim dhe artikujt bazë gjatë 2 muajve të ardhshëm?”



Burimi: Autorët bazuar në të dhënat e vrojtimit të strukturuar

Figura 25 më poshtë paraqet rezultatet e pyetjeve mbi vlerësimin e pasigurisë ushqimore për familjet e anketuara në Librazhd. Rezultatet e analizës përshkruese tregojnë se 84% e të anketuarve kanë deklaruar apo pohuar se kanë përjetuar shqetësime lidhur me sigurimin ushqimor. Më tej, 73% kanë pohuar se ju duhej të ushqeheshin me një larmi më të kufizuar ushqimesh se normalisht.


Figura 25: Përgjigjet e pyetjeve për të vlerësuar pasigurinë e familjes për të aksesuar produkte ushqimore - Librazhd



Burimi: Autorët bazuar në të dhënat e vrojtimit të strukturuar

Më tej Figura 26 na tregon rezultatet se nëse këto shqetësime ndaj sigurimit të ushqimit të nevojshëm për familjen janë shkaktuar nga pandemia. Mbi 65% e familjeve që pohuan shqetësime lidhur me aksesimin dhe sigurimin e ushqimit deklarojnë se këto shqetësime u shkaktuan nga pandemia.

Figura 26: Shqetësimet ndaj sigurimit të ushqimit të nevojshëm për familjen ndodhi prej pandemisë - Librazhd



Burimi: Autorët bazuar në të dhënat e vrojtimit të strukturuar

Niveli i Pasigurisë (qasjes) Ushqimore në Familje ofron informacion të përmblëdhur mbi mundësinë që një familje të përjetojë një ose më shumë sjellje në secilën nga tre fushat e pasqyruara në HFIAS të cilat janë ankthi dhe pasiguria, cilësi e pamjaftueshme dhe sasi e pamjaftueshme ushqimore. HFIAS ka një vlerë mesatare 7 për Bashkinë Librazhd në total por sipas njësive merr vlera të ndryshme (Hotolisht 3, Qendër 8, Qukës 12) (Tabela 40). Këto vlera tregojnë se familjet e anketuara në njësinë administrative Qukës kanë një nivel të lartë të pasigurisë ushqimore në familje krahasuar me njësitë e tjera. Po të krahasojmë nivelin e pasigurisë ushqimore të zonës në total dhe kësaj njësie, kuptojmë që familjet në Qukës janë 3 herë më të rrezikuara drejt pasigurisë ushqimore se mesatarja e totalit të familjeve të observuara në studim, ndërsa familjet në njësinë Qendër janë dy herë më të rrezikuara drejt pasigurisë ushqimore se mesatarja e totalit të familjeve të observuara në studim.


Tabela 40: Niveli i Pasigurisë (qasjes) Ushqimore në Familje - Librazhd

Treguesi	Librazhd				Zona e projektit
	Njësia administrative			Total	
	Hotolisht	Qendër	Qukës		
Observime në total	27	70	14	111	439
Niveli i HFIAS (mesatare)	3	8	12	7	4
Observime të vlefshme	89%	93%	86%	91%	99%

Burimi: Përlllogaritje të autorëve bazuar në të dhënat e vrojtimit të strukturuar

Në lidhje me Prevalencën e Pasigurisë Ushqimore në Familje (HFIAP) Figura 27 konfirmon atë çka u paraqit në Tabela 40 më lart, pra njësia administrative me nivelin më të lartë të pasigurisë ushqimore është njësia Qukës (86%) më pas njësia Qendër (36%). Në total për bashkinë, rezultatet e analizës përshkruese tregojnë se vetëm 19% e familjeve të anketuara në Librazhd kanë siguri ushqimore.

Figura 27: Niveli i siguri së ushqimore për familjet në bashkinë Librazhd dhe sipas njësive administrative respektive



Burimi: Përlllogaritje të autorëve bazuar në të dhënat e vrojtimit të strukturuar

11. Konkluzione dhe rekomandime

Konkluzione

Popullsia në familjet e intervistuar në bashkinë Librazhd është e një moshe relativisht më të vjetër (36.2 vjeç, 35.5 vjeç pa vlerat ekstreme) krahasuar me zonën e projektit; kjo i detyrohet kryesisht proporcionit më të ulët të fëmijëve. Raporti i varësisë është i njëjtë krahasuar me zonën e projektit por qartësisht më i ulët krahasuar me mesataren e vendit.

Burimet më të rëndësishme priodhuese në Bashkinë Librazhd janë toka bujqësore, livadhet e kullotat, pyjet dhe burimet turistike. Duhet theksuar se bazuar në informacionin cilësor (në grupet e fokusuar dhe përfaqësuesit e njësive bashkiake), burimet turistike janë shumë të rëndësishme në bashkinë e Librazhdit (përfshirë edhe Njësinë bashkiake Qukës). Burimet turistike përmbajnë potencialin e zhvillimit të turizmit rural dhe turizmit familjar.

Sipërfaqja e tokës në pronësi është 7.7 dymymë për familje (7.3 dymymë pa vlerat ekstreme, dhe sipërfaqja e tokës së përdorur (si proksi për përmasën e fermës) është 7.7 dymymë, 17.4 dymymë pa vlerat ekstreme. Një diferencë e tillë, shumë e vogël mes tokës në pronësi të familjes dhe tokës së përdorur nga familja (proksi për përmasën e fermës) vjen për shkak të mungesës së tregut të qerasë në bashkinë e Librazhdit – Vetëm 3 nga 111 familje në Librazhd kanë marrë tokë ne qera dhe asnjë prej tyre nuk ka deklaruar se ka dhënë tokë më qera.

Aktivitetet më të rëndësishme bujqësore në Bashkinë Librazhd mendohen të jenë ato të prodhimit blegtoral, konkretisht mbarështimi i imtave dhe gjedhit, pemët kryesisht vreshtat dhe arrorët (lajthia), bletaria, turizmi dhe bimët medicinale.

Familjet e anketuara në zonën e Librazhdit janë të orientuara drejt bimëve të arave dhe vreshtarisë. Përpunimi në fermë është një aktivitet bujqësor shumë i përhapur, ku rëndom gjenden në prodhimet familjare vera, rakia, turshitë, reçelrat, etj. Fermat blegtorale në njësitë e zgjedhura administrative në Librazhd janë të përfshira në aktivitete blegtorale të gjedhit (87% e të anketuarve), shpendëve (98%), bletëve (në 24% - kryesisht njësia Hotolisht) dhe të imtave (35%). Fermerët që mbarështojnë gjedh kanë mesatarisht 1 lopë për fermë. Gjithashtu, një pjesë e vogël kanë të imta, ku mesatarisht një fermë të imtash ka 7 krerë dele/dhi. Ato familje që merren me mbarështim bletësh kanë mesatarisht 5 koshere për fermë dhe shpendrritja është aktivitet shoqërues i fermës. Prodhimi më i hasur në produkte blegtorale janë kryesisht vezët, mjalti, mishi i shpendëve dhe mishi i gjedhit.

Të ardhurat nga bujqësia janë akoma shumë të ulëta dhe ato mbeten vetëm një pjesë e vogël e të ardhurave totale të familjeve. Rreth 90% e fermerëve të anketuar në Librazhd kanë të ardhura nga ferma, që nga ana tjetër këto të ardhura zënë mesatarisht 23% të të ardhurave të familjes. Ndryshe nga zonat e tjera rreth 90% e të ardhurave vijnë nga jashtë ferme, të cilat zënë rreth 55% të të ardhurave familjare vjetore të familjes. Shpenzimet mujore të familjeve të anketuara në Librazhd janë rreth 38,300 lekë mesatarisht ose rreth 15,000 lekë nën shpenzimet e nevojshme. Më tej, një familje në Librazhd përfiton mesatarisht 58,460 lekë në muaj, ku rreth 35% të kësaj vlere, familjarët arrijnë ta kursejnë. Kjo vlerë është theksueshëm më e lartë se vlera mesatare e të gjithë zonës së projektit.

Nevojat prioritare për rritje kapacitetesh në Bashkinë Librazhd janë këshillim mbi specien dhe kultivarin si dhe të ushqyerit e bimëve bazuar në analizat e tokës, këshillim mbi mbrojtjen e bimëve, këshillim për mbrojtjen e shëndetit të kafshëve, si dhe asistencë për përfitimin nga skemat e qeverisë. Nevoja të tjera të rëndësishme për rritjen e kapaciteteve janë edhe rritje kapacitetesh për teknologjinë e prodhimit të verës, paketë teknologjike për arrorët (kryesisht lajthinë), trajnime për manaxhimin e turizmit, praktikat e pasvëljes në BAM, riprodhimin në gjedh dhe edukimin financiar e llogaritje kostoje. Metoda më e preferuar nga fermerët e intervistuar të Librazhdit është është klasë dhe terren si dhe ndihma individuale (coaching).

Qasja për ofrimin e shërbimit të këshillimit mund të konsiderojë kombinimin e mbështetjes financiare në shkallë të vogël me shërbimin e këshillimit dhe rritjes së kapaciteteve. Lajthia, si bimë e provuar rishtazi në bashkinë e Maliqit, mund të mbështetet sipas kësaj qasjeje.

Pesë partnerët më të rëndësishëm të zhvillimit në Librazhd (renditur sipas numrit të përgjigjeve pozitive) janë njësia bashkiake, shkolla profesionale, blerësit e produkteve dhe drejtorja e bujqësisë. Listohet edhe një “partner tjetër” (kryesisht WVAK). Tregtarët e inputeve dhe AZHBR janë gjithashtu partnerë për tu konsideruar.

Vendi i zakonshëm për diskutimet lidhur me teknologjinë e prodhimit (dhe eventualisht edhe për çështje të tjera) është qendra e fshtatit ose lagjja. Të gjithë fermerët e intervistuar konsiderojnë lagjen si vendin e zakonshëm për diskutime teknike dhe pothuaj të gjithë fermerët konsiderojnë fshatin si vendin e diskutimeve teknike. Njësia administrative është gjithashtu një mjedis i rëndësishëm komunikimi ndërsa bashkia duket se konsiderohet si më distante për fermerët.

Interneti është mënyrë e rëndësishme e komunikimit të fermerëve me specialistët për marrjen e informacionit lidhur me teknologjinë dhe tregjet dhe më pak marrjen e informacionit lidhur me inputet. Pandemia ka patur një ndikim të rëndësishëm në intensitetin e komunikimit. Duket se ajo ka prekur institucionin më të rëndësishëm të marrjes së informacionit dhe zgjidhjes së problemeve - kafenenë në qendër të fshatit (96.4% e fermerëve e kanë ndjerë këtë mungesë).

Pandemia ka ndikuar në aksesin në treg ku mbi ½ e tregtuesve të perimeve, mishit të shpendëve dhe vezëve, kanë patur ulje të të ardhurave nga shitja të këtyre produkteve. Të ardhurat nga blegtoria kanë pësuar ulje për shkak të pandemisë për shumicën e familjeve (74% e familjeve me të ardhura nga blegtoria), ndërsa 89% e familjeve me të ardhura nga bujqësia (të cilat përbëjnë mesatarisht 65% të totalit të familjeve në Librazhd) kanë pësuar ulje në këto të ardhura për shkak të pandemisë. Të ardhurat me burim dërgesat nga emigracioni është një tjetër kategori të ardhurash që ka pësuar ulje për shkak të pandemisë (më e dukshme dhe më e përhapur në njësinë Hotolisht).

Niveli i vështirësisë në konsumin e produkteve bujqësore dhe blegtorale përgjatë muajve mars-prill për shumicën e familjeve të anketuara në Librazhd ka qenë në nivel më të lartë se në rajone të tjera të studimit. Rreth 51% e të anketuarve deklarojnë se e kanë patur shumë të vështirë konsumin e produkteve të paketuara si makarona, oriz apo vaj. Grupi i produkteve vështirësisht të aksesueshme kanë qenë produktet e bulmetit. Duket se ka një lidhje të drejtpërdrejtë midis aftësisë vetëprodhuese dhe vështirësisë për të konsumuar një produkt të caktuar. Konkretisht, në Hotolisht vetëm 50% e fermerëve arrijnë të vetëprodhojnë produkt bulmeti, e si pasojë pjesa më e madhe e tyre vuajtën aksesin ndaj këtij grupi produktesh përgjatë periudhës së pandemisë.

Niveli i Pasigurisë (qasjes) Ushqimore në Familje ka një vlerë mesatare 7 për Bashkinë Librazhd në total por sipas njësive merr vlera të ndryshme (Hotolisht 3, Qendër 8, Qukës 12), çka tregon një nivel të lartë të pasigurisë ushqimore në familje krahasuar me njësitë e tjera. Po të krahasojmë nivelin e pasigurisë ushqimore të zonës në total dhe kësaj njësie, kuptojmë që familjet në Qukës janë 3 herë më të rrezikuara drejt pasigurisë ushqimore se mesatarja e totalit të familjeve të observuara në studim, ndërsa familjet në njësinë Qendër janë dy herë më të rrezikuara drejt pasigurisë ushqimore se mesatarja e totalit të familjeve të observuara në studim. Në lidhje me Prevalencën e Pasigurisë Ushqimore në Familje (HFIAP) duket se njësia administrative me nivelin më të lartë të pasigurisë ushqimore është njësia Qukës (86%) më pas njësia Qendër (36%).

Rekomandime

Nisur nga gjetja se toka bujqësore e përdorur, livadhet (dhe kullotat) dhe pyjet janë tre burimet më të rëndësishme prodhuese në bashkinë Librazhd, projekti mund të konsiderojë një program rritje kapacitetesh për përdorimin e qëndrueshëm të këtyre burimeve. Aktivitete për t'u konsideruar mund të ishin, për shembull, praktika të mira të ruajtjes së shëndetit dhe funksionalitetit të tokës, manaxhimi i kullotave kolektive, mënyrat e vjeljes së bimëve medicinale dhe aromatike, veprimi kolektiv për manaxhimin e kullotave e pyjeve, etj.

Strategjitë më të rëndësishme të jetesës së të varfërve të zonave rurale përfshijnë përmirësimin e aksesit në asete dhe burime, aktivitet bujqësor, migrim dhe emigrim dhe punësimin jashtë fermave. Progresi në këto fusha përbën themelin për rritjen në sektorin bujqësor dhe zhvillimin e qëndrueshëm të zonave

rurale. Në përgjithësi, do të jetë thelbësore lehtësimi i aksesit në toka për fermerët produktivë duke bërë tregun e qiradhënies për tokën e përbashkët më të aksesueshme.

Projekti mund të konsiderojë ndërmjetësimin e një marrveshjeje mes bashkisë, fermerit dhe drejtorisë së pyjeve për arritjen e marrveshjeve më afat-gjatë në përdorimin e kullotave. Kjo do të ndikonte në përmirësimin e manaxhimit të kullotës dhe rritja e motivimit të fermerit për investime. Duke qenë se hapësirat e përbashkëta janë akoma të pakufizuara, promovimi i aktivitetit të bletërritjes, kultivimi i arroveve dhe të imtave është më i mundur për afatin e shkurtër. Në partneritet me sipërmarrje private nga jashtë zonës mund të koordinohen aktivitete kontraktuese me prodhuesit e verës, njësitë e shitjes së produkteve tradicionale dhe eksportuesit e bimëve mjekësore dhe aromatike.

Për produktet e konsideruara me potenciale zhvillimi janë blegtorja (të imtat dhe gjedhi), pemët frutore (kryesisht vreshtat), prodhimi i arrorëve, kultivimi i BAM, (si dhe bletaria dhe turizmi), fokusi në rritjen e kapaciteteve duhet të vendoset në nevojat prioritare, duke përdorur kryesisht kombinimin e klasës me terrenin dhe ndihmën individuale. Nga ana tjetër, praktika të testuara të mbështetjes me asete fizike në natyrë, me paketa teknologjike për familjeve më në nevojë mund të jenë qasje efikase për rritjen e kapaciteteve. Në rastin e kultivimit rishtaz të arrorëve është e nevojshme që krahas ofrimit të fidanëve, fermerët të asistohen me paketë të plotë teknologjike. Kombinimi i ofrimit të aseteve të vogla me paketë teknologjike mund të konsiderohet gjithashtu edhe në rastin e prodhimit të verës – fermerëve mund tu ofrohen tankera inoksi të përshtatshme për prodhim vere por ata duhet të asistohen gjithashtu për njohjen e teknologjisë së prodhimit të verës. Rritja e kapaciteteve në grupe fermerësh, sipas praktikës së deritanishme të operimit të WVAK, duhet të preferohet ndaj mbështetjes për individë të veçantë.

Në rasin e çdo mbështetjeje, rëndësi kritike ka përzgjedhja e fermerëve që mbështeten, duke përdorur kritere të besueshme, të tilla përshembull si besueshmëria, të qenit dinamik, aktiv, proaktiv, etj.

Nisur nga praktika e deritanishme e këshillimit, qasja dhe kapacitetet, ndërtimi i partneritetit me njësinë bashkiake, shkollën(at) profesionale blesit e produkteve duhet të konsiderohet me përparësi, krahas partneritetit klasik me drejtorinë e bujqësisë, tregtarët inputeve dhe konsulencën nga agjencitë e zhvillimit.

Rekomandohet që fermerëve tu ofrohet këshillim në 'habitatit' e tyre, si një rrugë për rritjen e efektivitetit të aktiviteteve të rritjes së kapaciteteve.

Krahas metodave tradicionale (të komunikimit fizik) të këshillimit dhe informimit, rekomandohet edhe eksplorimi i komunikimit virtual (përmes internetit) për rritjen e kapaciteteve. Kjo bëhet e mundur nisur nga fakti që fermerët aktualisht e përdorin internetin si mënyrë komunikimi.

Treguesit e ndikimit të pandemisë në funksionimin e fermës ka qenë të paqartë për shkak të mungesës së përgjigjeve. Shumë pak të anketuar përmendin pamundësinë për të blerë mekanikë, farë apo plehra për mbjellje. Duke marrë në konsideratë aftësitë vetëprodhuese dhe mangësitë që sjell mbyllja e qarkullimit të lëvizjes për shitjet informale (ecejaket drejt qytetit, levizja e automjeteve, etj).

Konsumi në ferma është pjesërisht i mbështetur nga vetëprodhimi sidomos në vezë, mish e më pak në fruta, perime e drithëra. Probleme u vunë re në njësinë Hotolisht në lidhje me prodhimet bulmetore. Asistenca me blegtori për familjet në këto zona është e nevojshme në periudhën afatmesme me qëllim rritjen e sigurisë ushqimore. Nevoja për mbështetje e fermerëve në rast të një faze të pandemisë së dytë do ishte ofrimi i inputeve të domosdoshme dhe rritja e mundësive të shitjes për produktet e ruajtura. Ndikimet e tjera janë në produktet e freskëta ku fermerët duhet të trajnohen në manipulimin dhe ruajtjen e tyre në rast të bllokimit të shitjes.

Gjithashtu ndihma duhet të ofrohet tek ato familje që posedojnë më pak tokë për frymë. Njësia administrative Hotolisht duket se shpreh nevojën më të madhe për ndërhyrje në rritjen e disponimit të sipërfaqes së tokës së përdorur. Kjo njësi, duke qenë se ka edhe më pak akses në treg, mund të synohet të ndihmohet për rritjen e mëtejshme të të ardhurave jashtë ferme. Në zonat më larg atyre urbane projekti duhet gradualisht të ofrojë mundësi për rritjen e të ardhurave jashtë fermes. Rreth 90% e fermerëve tregojnë që kanë të ardhura jashtë fermës të cilat zënë më pak se një e treta e të ardhurave vjetore në familje. Personat me aftësi duhet të orientohen drejt mjeshtrive të kërkuara në treg ku rëndësi duhet ti

jepet zanateve jashtë ndërtimit. Përzgjedhja e përonave duhet të kryhet duke marrë në konsideratë ngarkesat e detyrave familjare, aspektet gjinore dhe kushtëzime të tjera të fermës familjare.

12. Referencat

Coates, J., Swindale, A., & Bilinsky, P. (2007). Household Food Insecurity Access Scale (HFIAS) for measurement of food access: indicator guide: version 3. E aksesueshme online në lidhjen: http://www.fao.org/fileadmin/user_upload/eufao-fsi4dm/doc-training/hfias.pdf

INSTAT (2020). Vjetari statistikor i Bujqësisë dhe i Blegtorisë 2019. Të aksesueshme online në lidhjen <http://instat.gov.al/al/temat/bujq%C3%ABsia-dhe-peshkimi/bujq%C3%ABsia/#tab2>

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (2017). Plani i përgjithshëm vendor i Bashkisë Dibër (2017). Strategjia territoriale dhe Plani i zhvillimit. I aksesueshëm online në lidhjen <http://planifikimi.gov.al/index.php?id=732>

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (2017). Plani i përgjithshëm vendor i Bashkisë Kurbin (2017). Strategjia territoriale dhe Plani i zhvillimit. I aksesueshëm online në lidhjen <http://planifikimi.gov.al/index.php?id=732>

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (2017). Plani i përgjithshëm vendor i Bashkisë Librazhd (2017). Strategjia territoriale dhe Plani i zhvillimit. I aksesueshëm online në lidhjen <http://planifikimi.gov.al/index.php?id=732>

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (2017). Plani i përgjithshëm vendor i Bashkisë Përrenjas (2017). Strategjia territoriale dhe Plani i zhvillimit. I aksesueshëm online në lidhjen <http://planifikimi.gov.al/index.php?id=732>

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (2020). Plani i përgjithshëm vendor i Bashkisë Maliq (2020). Strategjia territoriale dhe Plani i zhvillimit. I aksesueshëm online në lidhjen <http://planifikimi.gov.al/index.php?id=732>

Anekset

Tabela 41: Struktura moshore e popullsisë në Librazhd

Zona e Programit	Librazhd							
	Njësia Administrative						Total	
	Kastriot		Maqellare		Tomin			
deri ne 4 vjeç	3	2.3%	8	2.3%	2	2.8%	13	2.4%
5 deri 9 vjeç	8	6.2%	17	5.0%	7	9.7%	32	5.9%
10 deri 14 vjeç	17	13.1%	22	6.4%	5	6.9%	44	8.1%
15 deri 19 vjeç	10	7.7%	26	7.6%	9	12.5%	45	8.3%
20 deri 24 vjeç	16	12.3%	52	15.2%	5	6.9%	73	13.4%
25 deri 29 vjeç	2	1.5%	38	11.1%	3	4.2%	43	7.9%
30 deri 34 vjeç	6	4.6%	21	6.1%	4	5.6%	31	5.7%
35 deri 39 vjeç	13	10.0%	14	4.1%	2	2.8%	29	5.3%
40 deri 44 vjeç	8	6.2%	23	6.7%	2	2.8%	33	6.1%
55 deri 49 vjeç	13	10.0%	15	4.4%	6	8.3%	34	6.3%
50 deri 54 vjeç	10	7.7%	36	10.5%	6	8.3%	52	9.6%
55 deri 59 vjeç	3	2.3%	20	5.8%	5	6.9%	28	5.1%
60 deri 64 vjeç	3	2.3%	17	5.0%	5	6.9%	25	4.6%
65 deri 69 vjeç	2	1.5%	15	4.4%	2	2.8%	19	3.5%
70 deri 74 vjeç	5	3.8%	11	3.2%	3	4.2%	19	3.5%
75 deri 79 vjeç	7	5.4%	7	2.0%	2	2.8%	16	2.9%
80 deri 84 vjeç	2	1.5%	0	0.0%	4	5.6%	6	1.1%
mbi 85 vjeç	2	1.5%	0	0.0%	0	0.0%	2	0.4%
Total	130	100.0%	342	100.0%	72	100.0%	544	100.0%

Burimi: Autorët bazuar në të dhënat e vrojtimit të strukturuar


Tabela 42: Perceptimet e fermerëve mbi aktivitetin e dytë dhe të tretë potencial

Aktivitetet ekonomike	Prioriteti i dytë			
	Librazhd		Zona e projektit	
	Numër	%	Numër	%
Të imtat	36	32.4%	68	15.5%
Bletaria	15	13.5%	33	7.5%
Prodhimi i frutave (pa aroret)	11	9.9%	53	12.1%
Turizmi në fermë	11	9.9%	13	3.0%
Prodhimi i arroveve	9	8.1%	39	8.9%
Gjedhi	8	7.2%	102	23.2%
Kultimi i BAM	5	4.5%	19	4.3%
Përpunim fruta-perime në fermë	5	4.5%	13	3.0%
Përpunim qumështi në fermë	5	4.5%	14	3.2%
Akuakultura	3	2.7%	6	1.4%
Tjetër	3	3%	62	14%
Total	111	100.0%	433	98.6%
Prioriteti i tretë				
Të imtat	9	8.1%	27	6.2%
Bletaria	36	32.4%	71	16.2%
Turizmi në fermë	23	20.7%	32	7.3%
Prodhimi i frutave (pa aroret)	12	10.8%	70	15.9%
Akuakultura	7	6.3%	10	2.3%
Kultimi i BAM	6	5.4%	26	5.9%
Gjedhi	4	3.6%	24	5.5%
Prodhimi i arroveve	4	3.6%	34	7.7%
Përpunim fruta-perime në fermë	3	2.7%	27	6.2%
Përpunim qumështi në fermë	2	1.8%	17	3.9%

Tjetër	5	4.5%	101	23.0%
Total	111	100.0%	439	100.0%

Burimi: Autorët bazuar në të dhënat e vërtimit të strukturuar

Figura 28: Nevoja e parë prioritare për rritje kapacitetesh për produktin e dytë prioritar



Burimi: Autorët bazuar në të dhënat e vërtimit të strukturuar

Tabela 43: Përqindjet e vlefshme (pjesa e të anketurave që i është përgjigjur pyetjes mbi ecurinë në vlerën e shitjeve të produkteve blektorale krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2019 (bashkia Librazhd)

Produkti	Përqindja e përgjigjeve (ndaj totalit)
1. Mish i therur (të imta)	23%
2. Kafshë të gjalla (të imta)	19%
3. Mish i therur (gjedh)	19%
4. Kafshë të gjalla (gjedh)	55%
5. Qumësht dhie	14%
6. Qumësht dele	13%
7. Mish derri	6%
8. Mish shpendësh	66%
9. Mjaltë	21%
10. Vezë	68%
Totali i observimeve Librazhd	111 observime

Burimi: Autorët bazuar në të dhënat e vërtimit të strukturuar

Tabela 44: Sipërfaqja e bimëve të arave sipas bashkive 2019

Nr	Bashkia	Drithëra	Grurë	Misër	Theker	Perime	Patate	Fasule	Foragjere	BAM
1	Dibër	3,661	520	3,000	50	550	288	138	10,550	8
2	Librazhd	1,990	575	1,288	65	266	274	340	2,549	5
3	Prrenjas	1,683	670	963	26	172	142	224	1,661	7
4	Maliq	6,790	4,426	1,648	87	1,220	1,010	524	4,469	49
5	Kurbin	1,539	690	829	-	615	112	190	5,210	14

Burimi: INSTAT (2020)

Tabela 45: Prodhimi i bimëve të arave sipas bashkive 2019

Nr	Bashkia	Drithëra	Grurë	Misër	Theker	Elb	Tagjira	Perime	Patate	Fasule	Foragjere	BAM
1	Dibër	22,291	2,010	19,976	100	108	97	14,612	8,478	1,517	226,651	5
2	Librazhd	9,434	2,270	6,874	163	-	127	5,824	6,439	660	84,080	9
3	Prrenjas	7,649	2,664	4,867	65	-	53	3,751	3,341	414	56,474	14
4	Maliq	31,037	19,246	9,689	222	1,256	624	36,858	31,014	819	136,743	78
5	Kurbin	9,380	2,760	6,558	-	-	62	17,046	3,584	357	209,775	126

Burimi: INSTAT (2020)

Tabela 46: Prodhimi i perimeve sipas bashkive 2019

Nr	Qarku	Perime të Njoma	Perime të Thata	Bostanore	Perime Gjithsej
1	Dibër	10,979	2,439	1,194	14,612
2	Librazhd	4,731	812	282	5,824
3	Prrenjas	3,036	570	145	3,751
4	Maliq	9,702	26,159	997	36,858
5	Kurbin	11,809	982	4,255	17,046

Burimi: INSTAT, 2020

Tabela 47: Gjendja numerike e drufrutorëve, 2019

Nr	Bashkia	Pemë frutore	Ullinj	Agrume	Vreshti (Ha)	Pjergulla
1	Dibër	880	-	-	64	143
2	Librazhd	187	4	-	43	100
3	Prrenjas	137	-	-	86	68
4	Maliq	718	-	-	168	82
5	Kurbin	198	115	18	139	197

Burimi: INSTAT (2020)

Tabela 48: Prodhimi i drufrutorëve, 2019 në Ton

Nr	Bashkia	Peme frutore	Rrush nga vreshti	Rrush nga pjergulla	Rrush gjithsej
1	Dibër	15,870	680	1,600	2,280
2	Librazhd	4,296	418	1,423	1,841
3	Prrenjas	3,412	857	985	1,842
4	Maliq	12,548	861	1,376	2,237
5	Kurbin	4,026	2,223	1,686	3,909

Burimi: INSTAT (2020)

Tabela 49: Numri i krerëve të blegtorisë sipas bashkive, 2019

Nr.	Bashkia	Gjedhë	Lopë	Të imta	Të leshta	Dele	Të dhirta	Dhi	Derra	Shpendë	Koshere bletë
1	Dibër	15,000	11,000	92,000	63,000	52,000	29,000	25,000	100	130,000	13,000
2	Kurbin	11,175	7,760	19,550	5,760	4,210	13,790	10,350	12,270	90,050	1,816
3	Librazhd	7,250	5,800	38,800	22,500	16,700	16,300	13,000	480	93,720	2,600
4	Maliq	9,999	8,032	93,221	74,120	60,478	19,101	15,443	2,339	103,691	8,498
5	Prrenjas	3,750	2,700	27,300	16,900	11,000	10,400	7,500	-	60,830	1,800

Burimi: INSTAT (2020)

Tabela 50: Prodhimi i qumështit, 2019 (Ton)

Nr.	Bashkia	Lopë	Dele	Dhi
1	Dibër	28,600	2,912	2,675
2	Kurbin	18,702	261	1,335
3	Librazhd	21,156	1,188	2,310
4	Maliq	36,144	3,629	1,699
5	Prrenjas	9,461	816	1,336

Burimi: INSTAT (2020)

Tabela 51. Prodhimi i mishit - peshë e gjallë, 2019 (ton)

Nr.	Bashkia	Gjithsej	Gjedhë	Të leshta	Të dhirta	Derri	Shpendë
1	Dibër	4,351	2,185	1,456	500	10	200
2	Kurbin	2,260	566	89	152	1,316	137
3	Librazhd	2,649	1,519	600	376	22	131
4	Maliq	3,861	1,804	1,378	369	207	103
5	Prrenjas	1,414	694	394	240	-	85

Burimi: INSTAT (2020)